

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JA-32

5428



Bashkim Shehu

**NJË
KOHË
TJETËR**

NOVELË E TREGIME


814-52

5429.

BASHKIM SHEHU

NJË KOHË TJETËR

Novelë e tregime



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KOMPOZIM ME BASORELIEV DHE GRUP SKULPTUROR

I

Në një qytet të vogël kishte nisur prej disa kohësh ndërtimi i Muzeut të ri të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Ky do të ishte më i madh dhe më i zgjeruar se ajo pjesë e muzeut lokal, që i përkiste periudhës së Luftës. Ndërtimi i tij qe diçka me rëndësi për qytetin dhe për gjithë rrethin.

Në mbledhjen që bëri për këtë Komiteti i Partisë i Rrethit, u propozua që në muze të kishte një statujë, apo një skulpturë tjetër çfarëdolloj për luftën partizane. Arkitekti, i cili gjithashtu bënte pjesë në mbledhje, e mori përsipër këtë, duke thënë se njihte një skulptor të ri.

*

* *

Studioja ime është një dhomë jo fort e ngushtë. Ka një karrige, një tavolinë, shumë fletë të mbërthyera në mure. Në fletë janë bërë gjithfarë vizatimesh: me karbon, me pastel, me guash, pjesa më

e madhe prej të cilave janë skica që më duhen për skulpturën, pasi ky është profili im. Por shpesh ndodh që vizatimet i vazhdoj deri në fund dhe kështu ato i kapërcejnë kufijtë e etydit. Sa për punët që kam bërë në skulpturë, aty mund të përfshihen disa buste, ca statuja dhe ndonjë kompozim, të gjitha këto në dimensione të vogla. E vetmja gjë e arritur, sipas mendimit tim, është një kalë prej guri, që mua më pëlqen ta quaj «Kali i Trojës»; në sytë e tij jam munduar të vendos një shprehje të ftohtë, të largët, një farë qetësie kërcënuese; ai është i përbërë prej blloqesh të shtangëta, ku synimi im ka qenë të përdor vetë materialin si mjet estetik.

E shoh se u shmanga pak nga ajo që dua të tregoj, po do ta tregoj tani, sa më shpejt. Më në fund, m'u dha mundësia të bëj një kompozim në dimensione të mëdha: para disa ditësh më kërkuan nga Komiteti i Partisë i Rrethit një basoreliev, ose një skulpturë për një muze të ri të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që do të ndërtohet në qytetin tonë.

Ditën e parë më erdhi në kokë ideja të kompozjoja diçka që të kishte basoreliev dhe njëkohësisht disa trupa jashtë tij. Pak nga pak fillova t'i përfytyroja figurat. Diçka që gjendet në shtresat më të thella të ndërgjegjes, kishte filluar të lëvizte dhe të bëhej inkandeshente. Figurat më shfaqeshin si kuadrot e një filmi të projektuar me shpejtësi të tillë, që syri i njeriut nuk mund t'i perceptojë plotësisht, dhe kështu më krijonte një ndjesi të turbullt. Ky ishte shkaku që atë ditë, gjithashtu edhe të nesërmen, nuk arrita të skicoja asgjë të qartë, e kuptoja se duhej tani një punë e ngadaltë, pa ngutje, thujse si për zgjidhjen e një ushtrimi të matemati-

kës. Ditën e tretë shkova që në mëngjes në studio; vizioni më qe bërë çuditërisht i qartë. Kështu që arrita deri-diku të bëja një skicë të përgjithshme, të cilën pastaj ia çova arkitektit për ta parë. Ai më premtoi se, në qoftë se do të dilte mirë, do të bënte çmos që skulpturën ta derdhnin në bronz.

Që prej asaj dite vazhdoj punën pa ndërprerje dhe nuk merrem me asgjë tjetër, veç kompozimit që kam për muzeun. Tani kompozimi qëndron aty, në mes të studios, mbi bazamentin e madh. Armatura e basorelievit vjen e pjerrët dhe ka pak a shumë formën e një flamuri; mbi të do të skulpturohen figurat e veçanta, për të krijuar konfiguracionin e një sulmi partizan. Në skajin ku armatura është më e lartë dhe ka më tepër trashësi, do të jenë figurat e dy partizanëve që, në pjesën më të madhe, dalin jashtë basorelievit. Aty janë vendosur hekura të kryqëzuar, të përkulur, ku më vonë do të ngjeshet argjila. Ndërsa poshtë, nga bazamenti, dalin disa hekura të tjerë, më të shkurtër, të cilët ngjajnë si skeleti i ndonjë rrëshqanori. Ata janë për gjermanin.

Sot më erdhi në studio një burrë i shkurtër me kostum bojëkafe të mbyllur dhe me jakën e këmi-shës të nxjerrë përmbi xhaketë. Nuk e njihja këtë njeri, vetëm më duket se dikur e kisha parë një herë në shkallët e Komitetit të Partisë. Më tha se e quanin Zenel Dragoti dhe se nuk kishte ardhur i ngarkuar me ndonjë detyrë zyrtare, por thjesht me iniciativën e tij, i shtyrë nga ndjenja e përgjegjësisë shoqërore.

Si bëri një hyrje të dytë, duke më thënë se jam i ri dhe prandaj nuk duhet të jem pretencioz, ai u afrua te boceti prej gipsi, e kundroi një çast, pas-

taj bëri vërejtje rreth tij. Ai ishte i mendimit se boceti çalonte në disa drejtime, si p.sh. fytyrat e partizanëve janë pa shprehje, ose kanë, pak a shumë, të njëjtën shprehje etj. Dua të jem i sigurtë me ju, më tha në fund, të them të drejtën kam frikë se mos nuk e pasqyroni si duhet frymën heroiko-monumentale të Luftës, që duhet të ketë medoemos një vepër me përmasa të tilla.

Këtë nuk e them se më vjen keq kur më bëhen vërejtje, por është fakt, se përmasat e bocetit janë aq të vogla, sa nuk mund të shquhen karakteret, shprehjet e fytyrave, apo ndonjë detaj tjetër i imtë. Megjithatë mundet që vërejtjet të mos kenë qenë për punën e kryer, por për atë që do të vijë më vonë.

Sidoqoftë, në përgjithësi, nuk më pëlqejnë ata tipa që flasin shumë dhe që gjatë bisedës nuk dëgjojnë fare ç'thonë të tjerët.

*
* * *

Në studion time gjendet edhe një projektor i vjetër, që e përdor për ndriçim, sepse shpesh ndodh që punoj tërë ditën deri në mbrëmje. Ndonjëherë, kur lodhem, e ndërpres punën dhe dal e shëtis pak jashtë. Kohët e fundit më pëlqen të ulem pranë lumit, mbi gurët e rrumbullakët apo mbi disa arka të zbrazëta, që nuk arrijnë dot t'i fshehin lulet e mbjella në të dyja anët e lumit. Më parë, kur ishim fëmijë, venim shpesh aty dhe kalonim orë të tëra duke luajtur. Ulem dhe rri diku pranë, sodis lumin, pemët, siluetat masive të maleve, që fillojnë menjëherë në të dy brigjet.

Babai im ka pasur një jetë shumë të ashpër dhe, si duket, kjo është arsyeja që ai flet fare pak; edhe atëherë kur flet, përmend më tepër të kaluarën. E shoh vetëm një herë gjatë ditës, vetëm në darkë, kur kthehem. Zakonisht ai rri mbi minder duke pirë cigare dhe mendohet, mendohet. Ndërsa unë shkoj dhe ulem në tavolinë për të ngrënë. Babai gjithmonë më pyet shkurt si kalova. Edhe unë i përgjigjem po shkurt; ndoshta e kam të imponuar nga natyra e tij e heshtur. Por e di që përgjigje të tilla si «mirë», ose «hiç» atij s'para i pëlqejnë, sidoqoftë, di gjithashtu se nuk ma merr si nënçmim apo mungesë respekti. Ai është i bindur se nuk është kështu dhe i konsideron vetëm si disa huqe të padëmshme.

Sonte e pyeta në e njihte apo jo Zenelin.

— E njoh, — më tha babai, — megjithatë nuk mund të them se e njoh nga afër. Ai është nga R. Këtu ka ardhur pak vjet përpara, kur ti ke qenë në Tiranë. Punon në zyrat e komunales... Ka shumë fjalë, — shtoi pas pak me zë të ulët, thujse me vete.

Ai qëndronte mbi minder duke thithur cigaren dhe mendohej, mendohej. Në ato çaste mua m'u duk se në atë fytyrë, që shprehte një qetësi dhe vetësiguri gati të rëndë, në indet e saj që shkrirë diçka e drunjte dhe, nuk e di se si, menjëherë më erdhi në mendje një «Studim koke» nga Dyrer.

Shkova të flija. U shtriva, u ktheva për një kohë të gjatë sa në njërin krah në tjetrin, por gjumi nuk më merrte. Nuk më shqitej Zeneli. Shumë gjëra që po mendoja tani, nuk i kisha vënë ré menjëherë pas bisedës, ashtu sikurse një pikturë që, nga afër, të duket sikur ka njolla të vëna pa kujdes, ndërsa nga një farë largësie ato japin volume, plane, figura të qarta...

Në fillim, kur sapo erdhi në studio dhe, ndoshta, pak më tepër nga fjalët e tij të para, u gëzova, ngaqë mendoja se kisha të bëja me një njeri, me të cilin mund të bisedoja për artin. Por shpejt ky iluzion m'u zhduk, si një membranë e hollë mjegulle që grisët nga era. Fjalët e tij të fryra të përfitonin idenë e boshllëkut të ajrit. Tani unë jam plotësisht i vetëdijshëm se Zeneli është njeri i mërzitshëm dhe pa vlera. Megjithatë, nuk e marr vesh se si, ç'forcë e pakuptueshme më bën që të mos e largoj dot mendjen nga ai, saqë më duket sikur më ka ngjitur në tru një ventuzë që i thith gjithë mendimet e mia drejt tij.

II

Nga materialet e mbledhura për muzeun: Gjatë këtyre javëve erdhën pothuajse përditë grupe njerëzish, nga dy, nga tre, apo nga më shumë, që sillnin materiale. Kryesisht armë zjarri. Gjashtë pushkë. Tetë revolverë (dy nagante). Tetë granata dore. Gjithashtu dhe një mitraloz...

Ato grumbullohen në depon e vogël të një ndër-marrjeje, pranë vendit ku po ndërtohet muzeu. Një burrë me syze, me flokë të rënë, qëndron pranë tavolinës dhe shënon në evidenca. Njëzet e ca vjet më parë ai ka qenë intendent në një brigadë partizane; të gjithë thoshin se kjo koincidençë e bënte edhe më të dukshme ngjashmërinë midis preokupimit për muzeun dhe ndihmës së popullit për luftën partizane.

*

* *

Zeneli u kthye me fytyrë nga skulptori dhe, si bëri ca hapa, u ndal në mes të studios.

— Më pas u mendova thellë për ato që fola radhën tjetër, — tha ai, pa i hequr sytë nga fytyra e skulptorit, — dhe më duken të drejta... Në fund të fundit, ky është mendimi im. Sidoqoftë nuk duhet të ndikohesh prej tij. Ndoshta mund të mos ketë qenë ashtu siç duhet. Por, sidoqoftë, e kisha për të mirën tënde kur fola ashtu, të jesh i sigurt.

Mbi basoreliev që ngjeshur me gishta balta argjilore dhe pak a shumë kishte marrë forma. Më tepër ishin punuar, në vija të përgjithshme, pa u futur në detaje, trupat e njerëzve. Zeneli u përtyp, mblodhi buzët, pastaj ato u hapën dhe ai tha:

— Dëgjo. Të metat e skicës sate nuk janë zhdukur, mund të them se nuk ka ndryshim themelor nga skica. Këto që them unë, nuk duhet të ndikojnë dhe aq, — këtu toni ndryshoi, — figurat prapë sikur janë pa shprehje. Më të gjalla!... Dhe, sidomos, më heroike. Vepra jote ka vlerë pikërisht sepse

është monumentale me karakter heroik. Megjithatë mos i merr kallëp fjalët e mia, — përsëri ndryshim toni (vetëm në fjalët e fundit), — nejtë, edhe mund të të mërzis, se po bëhem llafoman. Po vetëm desha të të thosha se nuk duhet t'i marrësh kallëp këshillat që mund të të jap. Për këtë jam menduar mirë gjatë ditëve të fundit. — Këtu Zeneli përzuri me dorë një mizë që po fluturonte duke u vërtitur midis të dyve, sikur me largimin e saj të hiqte pengesën e fundit që e ndante nga skulptori. — E kam fjalën këtu: Ti je i ri, dhe i riu duhet të krijojë gjëra të reja, të thyejë koncepte, rutina... — Zeneli ndaloi për një çast, pastaj rifilloi menjëherë, sikur krejt papritur t'i ishte kujtuar diçka, — por nuk duhet lënë pas dore edhe e meta tjetër, që është skematizmi, megjithëse kjo nuk është shumë tipike për të rinjtë. Të dyja këto të meta të ndryshme janë të lidhura me njëra-tjetrën, sepse, si pasojë e përpjekjeve për të shmangur të metën e parë, mund të biesh në të metën tjetër, që është skematizmi.

Zeneli vazhdoi një copë herë të gjatë duke folur për të meta të tjera, si dhe për të metat që mund të vinin si pasojë e përpjekjeve të pasuksesshme për shmangien e të metave të para, ndërsa unë prisja të shihja se në çfarë meandrash do të kalonte lumi i fjalëve që dilte nga goja e tij. Por më kot, sepse ato vërtiteshin e vërtiteshin pa ndonjë drejtim të caktuar.

Është e mërzitshme që për një kohë të gjatë të dëgjosh prej kësi njerëzish një të tillë mënyrë të foluri, po prapë Maksi, një shoku im, nuk bëri mirë që u soll ashtu. Kur ai erdhi në studio, Zeneli sikur e parandjeu rrezikun; në sytë e tij pa shprehje dhe të vegjël, si dy brimat e zeza të prizës, për herë

të parë diçka lëvizi... Në të vërtetë, Maksi nuk i tha asgjë fyese, por vetëm u soll sikur nuk e vuri re fare praninë e një tjetri. Maksi nuk ka ndonjë interes të veçantë për artin, por besoj se nuk i erdhi mirë kur dëgjoi Zenelin të fliste ashtu dhe, si duket, deshi të hakmerrej për mua. Nga njëra anë, ndoshta kishte të drejtë që u soll në atë mënyrë. Sidoqoftë, unë nuk jam i aftë të bëj shumë gjëra që bën ai.

*
*
*

Zeneli hyri në kafe dhe u ul në tavolinën ku ishte ulur arkitekti. Pas një prologu të shkurtër, ai filloi t'i fliste arkitektit për rëndësinë e muzeut, për kuptimin e lartë të Luftës Nacionalçlirimtare, në të cilën kishte marrë pjesë edhe vetë... Në të folur e sipër po mundohej të gjente mënyrën më të përshtatshme për t'i kërkuar të shihte projektin e ndërtesës, apo sistemimin e ekspozateve të ndryshme. Në fillim, përmes njollash të mjegullta diellore, pastaj befas, brenda një kohe shumë të shkurtër, aq sa ç'i duhet diafragmës së një fotoaparati për të hapur e mbyllur objektivin, Zenelit iu bë sikur pa, me një qartësi të jashtëzakonshme, fotografinë e tij, të vendosur në stendën e kuqe të muzeut... Vizioni u zhduk menjëherë, ndërsa Zeneli vazhdoi qetësisht ligjëratën e tij.

Arkitekti trokiste gishtat vazhdimisht mbi tavolinë, me ritëm të njëjtë dhe në një çast gjeti rastin të ndërhynte:

— Njëherë sikur më keni thënë se punoni në

zyrat e Komunales, — tha ai, me atë pamje hutimi që kanë përherë njerëzit, kur mendojnë diçka të largët nga tema e bisedës. — Neve na duhen ca materiale, — vijoi arkitekti dhe, pasi nxori nga çanta e meshintë një copë letër, e hapi përpara Zenelit. — ja lista, — tha ai. — Ndërmarrja juaj mund të na ndihmojë. Ju kemi bërë një kërkesë... gjithashtu nesër do të vete në komitetin ekzekutiv. Sido që të jetë, shihni njëherë se ç'bëhet me kërkesën tonë, — fjalët e fundit i shqiptoi me një ton asnjans, që s'kishte asgjë të përbashkët me lutjen apo me urdhrin.

Pas pak të dy dolën në rrugë dhe u ndanë. Zeneli vazhdoi vetëm. Mbase do të qe më mirë të kisha takuar atë, ish-intendentin, atë me syze, tha ai me vete. Po përnjëherësh iu ravijëzua në kujtesë fytyra e tij, trajtat... Pas xhamave gjendeshin dy sy ngjyrë hiri të mbyllur, dy fushëtira të zhveshura, mbuluar tej e tej me ngricë, dhe shumë larg, në fund të tyre, në një sfond të largët me peisazh malor, regëtinin zjarret... Ai e ka mendjen te lufta. E ka mendjen te pushkët apo koburet që mblidhen për muzeun, ndoshta më tutje, ndoshta për historitë që lidhen me ndonjërin prej tyre. Ai jeton tërësisht në një botë tjetër dhe as që do më dëgjojë fare, tha me vete Zeneli, ndonëse mbrapa perdes së këtyre fjalëve të pakta qëndronte fshehur mendimi se nëpunësi me syze, ish-intendenti partizan, tregonte gjithmonë ftohtësi dhe mospërfillje të heshur ndaj tij... Zeneli pa orën. Sot s'paskam kohë për të vajtur te skulptori, mendoi, do të vete nesër.

Është vonë, gati mesnatë, por unë ende nuk kam dalë nga studioja. Përpara është kompozimi: hekura të kryqëzuar, të përkulur. Nga poshtë u bie drita e projektorit, dhe hijet e tyre në mur zgjaten e zgjaten me mundim. Mbi hekura, vende-vende, sapo është ngjitur balta argjilore. Më në fund arrita ta rifilloja punën. Pata një periudhë ngurrimi. Nuk e di tamam se çfarë më frenonte, por, pasi më vinte në mendje ndonjë ide, sa herë që afrohej çasti ta jepja në vepër, sa herë që afrohej koha për të punuar, nuk e gjeja më idenë; ajo që futur nëpër një labirint, ku unë vërtitesha pa arritur dot atje apo, më mirë, i kapur në tentakulat e një dyshimi të fshehtë, që më pengonin rrugën.

Shumë kohë më parë, kur isha dhjetë, apo tetë vjeç, këtë nuk e mbaj mend mirë, gjeta disa gurë alabastri. Atëherë nuk kisha asnjë njohuri për skulpturën, megjithatë, në mënyrë të habitshme, në volumet e rrumbullakëta, sferike, cilindrike të njërit prej tyre, m'u duk se kishte ngjashmëri, në vija të përgjithshme, me një nimfë që kisha parë në një libër me figura, të cilët, në atë moshë, më tërhiqnin. Kështu, nisa ta gdhendja gurin, në mënyrë që ta përafroja sa më tepër me figurën e nimfës. Vazhdova kështu ditë me radhë, në fshehtësinë më të madhe, ngaqë druhesha mos e merrnin vesh njerëzit e mi apo shokët...

Pra, vazhdova për ditë me radhë, duke gdhendur ngadalë gurin e alabastrit, duke iu afruar gjithnjë e më tepër asaj që përfytyroja. Më në fund, një ditë, mendova se kisha arritur t'i jepja ngjashmërinë e plotë, po, mbasi e vështrova pak, m'u duk e

kundërta. Iu futa punës rishtazi e, sa më shumë futesha në imtësi, aq më i përkryer më dukej shembëllimi. Por gjithmonë bindesha se kjo përkryerje nuk kishte fund...

Kur, ndërsa punoja, guri i alabastrit u ça më dysh, tërthor; në mes kishte një si zgavër dhe pak rërë.

* * *

Mbi hekura, vende-vende, është balta argjilore që sapo kam vendosur, akoma e lagësht dhe pa formë.

Herët e fundit që ka ardhur këtu Zenel Dragoti, po vë re se përpiqet, me perifraza, të më bindë se unë duhet ta dëgjoj, sepse ai ka qenë vetë partizan, e ka jetuar atë epokë, ndërsa unë i përkas një brezi tjetër, që nuk i ka njohur vuajtjet, luftën, ndaj dhe vështirë se mund t'i pasqyroj ato në art.

Ngjethem sa herë që mendoj se para disa ditësh, në periudhën e ngurrimit që përmenda më sipër, punimi im mund ta kishte marrë me të vërtetë atë rrugë. Tani vetëm mendoj se sa naiv dhe i gabuar kam qenë kur, me një farë nxitjeje nga përvoja e disa shokëve në kursin e fundit në institut, të cilët kapnin tema sociale dhe politike dhe i realizonin dobët, unë pandehja se kjo do të ishte rruga më e lehtë për një artist: kapje një temë të tillë, e përpunoje, realizoje më në fund një tablo apo një skulpturë sipas disa shablloneve dhe nuk do të nxirrnin telashe... nuk mund ta imagjinoja se sa telashe ka kjo rrugë, sa punë do, në qoftë se bën një angazhim serioz.

E njëjta orë. Diku në një pjesë tjetër të qytetit, Zenel Dragoti qëndronte shtrirë në krevatin e tij dhe flinte. Nuk dihej se çfarë imazhesh po kalonin tani nëpër qelizat e trurit që po punonin ende. Por fytyra e tij ruante shprehjen që kishte zakonisht kur qe zgjuar, një seriozitet me tone të lehta, që ka huajtur aftësinë për t'i dhënë rëndësi vetes; kjo shprehje vishte trajtat e fytyrës, ashtu sikurse një rrobë e përdorur nga një tjetër vesh një trup të ri, mbasi i janë rregulluar në një farë mënyre përmasat sipas këtij të fundit. Karriera e Zenelit kishte ndjekur një trajktore pak a shumë të qetë. Megjithatë ekzistonte një pjesë që mbetej në errësi të gjithmonë: ishte diçka që i pat kushtuar atij një ulje të menjëhershme. Pas saj, sigurisht, kishte filluar nga e para kacavjerrja plot mundim, e ngadaltë, por këmbëngulëse nëpër shkallët e administratës. Me ndihmën e një miku të tij me pozitë arriti përsëri në postin ku kishte qenë dhe ndoshta do të kishte shkuar më lart, sikur të mos kishte përreth njerëz që e njihnin mirë dhe dinin për atë... hijen, boshllëkun e tmerrshëm — humnerë në të cilën ai kishte frikë se mbas çdo çasti mund të binte... Kështu që ai bëri diçka tjetër: mori iniciativë, kërkoi largim për në një qytet të vogël dhe zuri një post në zyrat e Komunales.

Në vendin e ri të punës Zenel Dragoti bëri ç'mundi për ta mbuluar atë pjesë të biografisë së tij. Ai reklamohej si militant i flaktë, si njeri që ishte gati të sakrifikonte gjithçka për të mirën e shoqërisë, si një partizan i vjetër dhe nuk linte bisedë

për Luftën Nacionalçlirimtare apo takim veteranësh
pa shkuar.

IV

Mbledhje materialesh për muzeun.

Burri me syze, ish-intendenti i brigadës partizane, i cili qe ngarkuar të merrej me evidencat e materialeve për muzeun, thoshte gjithnjë se po grumbullohej material shumë më tepër nga ç'qe parashikuar, madje po vinin shumë gjëra, të cilat nuk i kishin pasur në muzeun e vjetër lokal. Mendimi i ish-intendentit ishte se ata që i sillnin, nuk i kishin dorëzuar deri tani, ngaqë kujtimet e tyre qenë të lidhura fort me to. Por në muzeun e ri që po ndërtohej, thoshte ai, merrnin pjesë të gjithë, dhe kujtimet e çdonjërit shkriheshin në kuitiesën kolektive, një konkretizim i së cilës do të ishte ky muze...

* * *

Pamja e arkitektit është ajo e një njeriu shumë të zënë me diçka dhe që s'ka kohë të merret me gjë tjetër. Ai nuk e duron dot zvarritjen në punë. Prandaj ishte shumë i shqetësuar për shkakun e disa zvarritjeve që pata gjatë një periudhe ngurrimi.


Me të erdhi në studio edhe një burrë tjetër, intendenti i brigadës partizane. Pamja e tij nuk të linte mbresë të veçantë, por në brendësi trupi ende ruante diçka të pazakonshme, diku mes damarësh dhe indesh muskulore, ca copëza predhe, tashmë

pjesë të pandara të organizmit. Ai tregoi një histori të thjeshtë nga lufta. Ai e kishte jetuar vetë ngjarjen që lidhej me një armë që i kishin sjellë këto ditë disa banorë të një krahine të largët të rrethit. Mendimet iknin pllajave, grykave, qyteteve të poraçliruara ose ku luftohej akoma, të ngarkuara me krisma, shpërthime bombash, zjarre nëpër natë. Njeriu që kisha përpara, veç copave të predhës, kishte mbartur nga ajo kohë në kujtesën e tij gjithë ato ngjarje nga lufta, për t'i sjellë në kohën tonë...

Këto ditë, edhe gjatë orëve kur kam pasur një tendosje të fortë nervore për shkak të shqetësimit për skulpturën time, vazhdimisht më ka ardhur në mendje ish-intendenti. Ai me siguri do të më kuptonte.

Herë pas here në studio vijnë njerëz për të parë kompozimin. Ata janë nga më të ndryshmit: disave u intereson si skulpturë, si art, disave më pak, por të gjithë që vijnë, janë të preokupuar për Muzeun e Luftës që po ndërtohet, dhe kjo, siç duket, i shtyn të shohin punën time. Zakonisht çdo ditë mund të ketë dy deri në tri vizita, ndonjëherë edhe më tepër.

Ndërkohë ardhjet e Zenelit po bëhen gjithmonë më të rralla. Ndodh që gjatë kohës që ai është në studio, vijnë njerëz të tjerë. Atëherë duket sikur gjithë ç'janë të ngurtësuar në qëndrimin e tij, shkrihen, ai m'paket, pëson një tkurrje brenda vetes. Rri ashtu për një farë kohe të shkurtër në studio, pastaj gjen çastin e përshtatshëm, kur të tjerët nuk e kanë mendjen, dhe largohet pa e kuptuar askush, thujse ikën duke rrjedhur që poshtë derës. Por rastis që vizitorët e tjerë largohen shpejt, dhe atëherë te Zenel Dragoti ndodh shndërrimi i për-



njëhershëm, dhe ai rimerr pamjen e zakonshme, me copa autoriteti të ngrira në trajtat e fytyrës.

Ndodh që, kur vjen në studio dhe sheh njerëz të tjerë, ikën përnjëherë; ndodh që vetëm nxjerr kokën te dera, përshëndet ose murmurit diçka, ose, kur të tjerët qëllon që nuk e pikasin, koka e tij zhduket me të shpejtë dhe pas saj mbyllet dera.

Unë gati harrova gjithçka të mëparshme të Zenelit dhe fillova të ndieja një farë keqardhjeje; ishte më tepër nga ato keqardhjet që ndien kur, pasi ke urryer intensivisht dikë, atij i bëhet një rënie dhe zhvleftësim aq i shpejtë, sa e kupton që nuk ishte i denjë për një të tillë urrejtje. Kështu edhe me Zenelin, por ai, si duket, e vuri ré këtë, sepse u bë më këmbëngulës, si në fillim. Dhe natyrisht, kjo gjë më shqetësoi.

Por e gjithë kjo, ndryshe nga sa mund të duket, zgjati fare pak, jo si radhën tjetër. Tani unë jam çliruar nga tentakulat e mosbesimit; këtë, me sa duket, edhe Zeneli kohët e fundit duhet ta ketë kuptuar. Sidoqoftë, vetë, vetëm fare, nuk do të isha çliruar dot.

*

* *

Mbledhje materialesh për muzeun.

Burri me syze dhe flokë të rënë, ai që dikur kishte qenë intendent në një brigadë partizane, u ul pranë tavolinës dhe hapi fletoren e trashë, ku qenë shënuar materialet e grumbulluara për muzeun. Tetë granata dore, një dylbi, dy makina shkrimi, dhjetë revolverë (dy nagante), një violinë...



Vazhdojnë të vijnë akoma njerëz në studio: kanë ardhur disa herë arkitekti, ish-intendenti, pastaj njerëz të tjerë të njohur, të panjohur, zakonisht nga dy, tre në ditë, ndonjëherë edhe më shumë.

Kompozimi qëndron aty, në mes të studios. Pak nga pak ai po përfundohet, me një punë gjithsesi të mundimshme. Ndonëse ka mjaft detaje të pambaruara, disa nga figurat e basorelievit dhe deri-diku tërësia e tij ka marrë formë. Gjithashtu ka mbaruar statuja e gjermanit, e shtrirë brinjazi, me helmetën e rëndë teutone mbi kokë dhe me gishtat e tij tërë nyje, skeletorë, të zgjatur si në një përpjekje për të ndaluar sulmin e partizanëve.

Kohët e fundit ndodh që e imagjinoj kompozimin të përfunduar, të derdhur në bronz, vendosur pranë një shkëmbi ndanë udhës, diku midis erërave, që ta shohë çdo kalimtar...

RËNIA E PERËNDIVE

Në terrin e natës katër njerëz po ngjiteshin në një rruginë të ngushtë. Ishin katër partizanë: dy prej tyre mbartnin në një tezgë shokun e plagosur, ndërsa pak më prapa ecte infermierja e batalionit. Era e ftohtë dimërore frynte parreshtur dhe toka e ngrirë u kërciste nën këmbë. Ndonëse kishin tërë pasditen që udhëtonin, spitali partizan ishte ende larg...

Mbas kësaj kodre duhet të jetë kisha, mendoj skuadërkomandanti. Atij nuk i kishte pëlqyer kundërshtimi i Martinit, i cili nuk pranonte të rrinin atë natë në kishë. Në fund të fundit, nuk ka të drejtë, përsëriti me vete skuadërkomandanti, shoku është plagosur rëndë dhe nuk i dihet. Ata ecnin me hapa të gjatë dhe të shpejtë, por duke u përpjekur që i plagosuri të kishte sa më pak tronditje. Sidoqoftë, në kishë është rrezik, vazhdoi me vete skuadërkomandanti.

— Atje do të bëjmë roje ne të dy, radhazi, — tha ai me zë.

Martini ngriti me njëren dorë jakën e palltos dhe nuk u përgjigj.

Pas pak para tyre u shfaqën konturet e një ndërtese me arkitekturë të rëndë bizantine, me një

kambanore të lartë. Dalngadalë, përmes errësirës, filluan të shquheshin më qartë muret e saj masive, dritaret, harqet. Nga brenda nuk vinte asnjë zë. Qetësi e shtangët. Vetëm zhurma e erës vazhdonte të dëgjohej, ndërsa kisha qëndronte aty si një përbindësh i gurtë.

Skuadërkomandanti trokiti tri herë në portën e madhe. Qetësi, asnjë zhurmë. Trokiti rishtas, kësaj radhe më fort. Atëherë u dëgjuan hapa, që, si dukej, zbrisnin nëpër shkallë dhe zëra. Mbrapa portës diçka lëvizti, ajo u hap ngadalë.

— Kush troket në këtë orë të vonë?

— Hape, uratë, kemi një të plagosur, — foli me të shpejtë skuadërkomandanti.

Partizanët, tha me vete prifti.

— Urdhëroni. Shtëpia e Krishtit është e hapur njëlloj për të gjithë nevojtarët.

Në zërin e tij fshihej me vështirësi shqetësimi. Skuadërkomandanti mblodhi buzët me përçmim, por askush nuk mundi ta shihte, për shkak të errësirës. Ngjitetën disa shkallë dhe kaluan nëpër sallën kryesore, ku kryheshin ceremonitë. Ajo ndriçohej dobët, ishin ndezur vetëm dy-tre nga shandanët e përhapur në të gjithë sallën. Në mure, mbi afresket që ilustronin paragrafët e Biblës, projektoheshin hijet e tyre, çuditërisht të deformuara dhe të zmadhuara në përmasa të panatyrshme, ndërsa hapat e tyre kishin një kumbim të mbytur, të largët. Përsëri shkallë. Në krye hapej një korridor i gjatë.

— Ne mund të hamë darkë të gjithë së bashku, me ato që na ndodhen. Për të plagosurin do të kujdesem posaçërisht, — tha prifti. Në fytyrën e tij endej një buzëqeshje e lehtë.

— Jo, — u përgjigj ftohtë skuadërkomandanti,

— faleminderit. Ne duam të shtrihemi, të çlodhemi pak. Në qoftë se ju ndodhet ndonjë gjë për mjekim...

— Si të dëshironi, — tha prifti, duke hequr sytë nga skuadërkomandanti, pastaj thirri: — Klio!

Zëri oshëtiu fort në korridor, jehona dukej sikur vinte nga të gjitha sallat, kthinat, të hyrat e të dalat e ndërtesës së madhe. Diku, nga një portë, doli një burrë me fytyrë të lodhur, me vija të thella, si brazda, në faqet e tij.

— Urdhëroni!

— Tregoju mysafirëve dhomat e fjetjes.

Prifti u largua drejt fundit të korridorit, ndërsa ai që quhej Klio, pa folur, u kthye në anën tjetër. Partizanët i shkuan pas.

— Këtu janë tri dhomat, — tha me zë të ulët, duke ndalur.

Ata hapën një portë dhe hynë brenda.

— Kjo hyrja tjetër është për zonjën.

Klioja priti një çast, por e kuptoi se askush nuk po ia vinte veshin dhe iku pa folur.

Mbas disa minutash ai u kthye përsëri, duke mbajtur kuti dhe shishe në duar; ndoshta mund ta kishte porositur prifti t'u jepte ilaçe. Njeriu i plagosur tani rrinte në njërin prej shtretërve të dhomës. Ajo që shumë e vogël dhe tavani që aq i ulët, sa të dukej sikur futeshe në një arkivol. Kishte vetëm një dritare, me xhama të trashë shumëngjyrësh, të cilët nuk lejonin të shihje përjashta.

— Shpejt do ta zëjë gjumi, — tha infermierja, duke treguar të plagosurin.

Klioja la ato që kishte sjellë dhe doli.

Dolën edhe partizanët në korridorin e zbrazët.

— Ja, edhe ilaçet na i dha, — tha Martini, —

por prapë, si mund të jetë njeri i ndershëm një prift që e ka kishën kaq të madhe?!

— Dëgjo, — tha skuadërkomandanti. — Punën e rojeve po e bëjmë kështu: deri më dy po rri unë, pastaj rri ti, deri në mëngjes, — vazhdoi ai, duke rregulluar në krah rripin e armës.

— Mirë, ashtu po e bëjmë.

— Mendoj se një vend i përshtatshëm do të ishte kambanorja.

Martini u fut brenda.

Skuadërkomandanti, i mbetur vetëm në korridor, vendosi të gjente Klion, që ta pyeste nga shkohej për te kambanorja. U kujtua se në portën ku ishte dukur Klioja në fillim, kishte vënë ré diçka që të bënte përshtypje: një dorezë të lakuar, me një kokë prej hekuri në skaj. Menjëherë gjeti një portë me dorezë të tillë, mirëpo, kur bëri ta hapte, vuri ré edhe një portë tjetër me po atë dorezë. Ktheu kokën, vështroi përreth: të gjitha portat kishin po ato doreza. Ato heshtnin tani përballë tij, si fytyra me trajta të paightifikueshme, anonime. Muret e korridorit zgjatëshin në të dy anët, si dy kafshë të mëdha memece.

Atëherë skuadërkomandanti mori nga ajo anë, ku mendonte se mund të gjente rrugën. U kthye në një vend, aty ku mbaronte korridori, shkoi nga e djathta, pastaj zbriti ca shkallë. Papritmas u gjend përsëri në sallën ceremoniale. Duke ecur gjatë një kolonade, arriti te një portë. E shtyu lehtë portën dhe, pasi bëri disa hapa në errësi të plotë, shtriu anash njëren dorë. Gishtat i prekën diçka të lagësht, jo pikërisht ashtu, por, sidoqoftë, diçka që

duhej ta kishte mbajtur lagështirën për një kohë të gjatë, dhe ai me zor e kuptoi që kishte prekur murin.

Edhe muret e kishës kanë historinë e tyre. Ka pasur kohëra kur ato kanë qenë të nxira, ka pasur kur ato shkëlqenin, kur ishin të lëmuara dhe të punuara bukur, apo kur bëheshin të ashpra, kur në kishë zhdukej çdo gjurmë festive dhe përmes suvave të stolisura shfaqeshin blloqe gurësh të papunuar. Kjo është një alternativë që përsëritet prej shekujsh, sepse kisha është shumë e vjetër, muret e saj kanë parë shumë gjëra.

Mbase dikur, atëherë kur kisha ka pasur shumë priftërinj, vazhdoi me vete skuadërkomandanti, te ky korridor mund t'i kenë pasur dhomat. Skuadërkomandanti e përfytyronte atë vend të errët njëlloj si korridorin e tyre, dhe ecte përpara duke prekur vazhdimisht murin dhe duke shpresuar se që aty do të dilte në ndonjë vend tjetër.

Muret e kishës nuk të shpien asgjëkundi. Në fund të tyre mund të gjesh ndonjë portë tjetër, që të nxjerr në ndonjë rrugë tjetër edhe më të ngatërruar, mund të gjesh ndonjë gropë të thellë, në të cilën bie papritur dhe nuk je më në gjendje të dalësh, apo mund të gjesh përsëri ndonjë portë që, kur ta hapësh dhe të përpiqesh të hysh, do të përplasesh prapë në mur, sepse pas portës nuk do të ketë asgjë.

Ai u kthye dhe doli nga korridori i errët.

*
* *
*

Djersë të ftohta mbulonin ballin, faqet, nofullat, mjekrën, krejt fytyrën e të plagosurit, ndërsa buzët e tij hapeshin e mbylleshin pa pushim dhe nxirrnin rrëke fjalësh të pakuptueshme, një pëshpëritje e zgjatur dhe pa fund, fraza pa lidhje, rrokje që shkëmbejnë vendet brenda fjalës, kombinime tin-gujsh që nuk formojnë dot asnjë fjalë. E gjithë kjo ngjante më tepër me një të folur primitiv, që nuk arrin deri në artikullim të plotë. Vetëm një herë, gjatë tërë natës, ai shqiptoi qartë diçka.

— Pse ma sollët priftin?... Unë nuk do të vdes... priftin, priftin... Ne nuk kemi nevojë për të...

Martini u bë gati t'ia shpjegonte, por infermierja i tha se ai nuk do të kuptonte asgjë.

— Jemi vetëm shokët e tu. S'ka tjetër njeri, — i tha Martini, — nuk të lëmë të vdesësh.

I plagosuri u ngrit përgjysmë me mundim, i mbështetur mbi bërryla dhe me muskujt e qafës të tendosur, sa që dukeshin sikur nga çasti në çast do të këputeshin.

— Ai prifti mbante në dorë një krah shpendi, — tha i plagosuri dhe koka e tij ra pa fuqi mbi jastëk.

Pastaj nisi përsëri ajo lëvizje buzësh dhe ai monolog i çuditshëm jokomunikues.

*
* *
*

Skvadërkomandanti mbështeti dorën në gurët e ftohtë. Përmes kolonave të kambanores, të cilat lart

bashkoheshin me harqe, shikimi i tij binte mbi kurizin e valëve të pllajës, që, e parë nga një farë lartësie, dukej edhe më e shkretë. Ajo ishte pothuaj krejt e zhveshur dhe vetëm tek-tuk kishte ndonjë pemë apo shkurre. Diku më afër ishin varrezat, me kryqet si të ngulura në dhé, ose si të dala nga dheu, si mumje të përjetshme me krahë të shtrirë dhe pa kokë.

Eshtrat janë një thesar më vete i kishës. Korterat të gjata besimtarësh vijnë përherë në ceremonitë kishtarë. Midis tyre do të shohësh njerëz me rroba zie, që sjellin dhurata të shumta. Janë ata që përkujtojnë ndonjë të vdekur. Dhe të vdekurit i varrosin aty, pranë kishës. Kisha i bën të vdekurit shumë të rëndë. Dhe ata rëndojnë mbi të gjallët. Barku i saj i vjetër grumbullon me ngadalë, me një durim që ka zgjatur në shekuj.

Në sajë të skeleteve që treten prej dhjetëra vjetësh në këtë oborr, mendoj skuadërkomandanti.

Disa nga kryqet prireshin nga një anë, disa nga ana tjetër, ndërsa era dimërore frynte pareshtur mbi pllajë, sikur mendohej t'i përkulte dhe t'i kërruste ca më shumë.

*
*
*

Klioja kaloi disa herë përpara dhomës, ku po rrinin partizanët. Sytë e tij të vegjël, si presje, lëviznin me shpejtësi dhe tregonin se ai ishte duke

përgjuar, ndërsa në kokë i vinin gjithfarë mendimesh të errëta: ishte i bindur se ata dy partizanët atje në dhomë po përlyenin nderin e kishës, po bënin gjërat më të turpshme. Pak më parë kishte shkuar te prifti, për t'i bërë të ditur hamendjen e tij, mirëpo përgjigjja e këtij të fundit nuk kishte qenë ajo që priste.

— Do ta shikojmë më vonë. — Vetëm kaq kishte thënë ai, fare i qetë.

Ai e di më mirë, kishte menduar Klioja duke u larguar...

Por, veç urrejtjes që ndiente për atë partizanin e ri, Klioja ndiente edhe diçka tjetër, të papërcaktuar, një farë kënaqësie të fshehtë, ndërsa sillte nëpër mend ato gjëra. Diçka që e kishte origjinën në një ngjarje të largët, gdhendur dobët në kujtesën e tij si figurë e një basorelievi të vagët, me konture që luhateshin aq shumë, sa vende-vende ai nuk mund të dallonte më asgjë; kjo kishte ndodhur kur ai ende nuk i kishte mbushur të njëzetat, një ditë kur disa fshatarë e kishin gjymtuar dhe lënë eunuk (shkaku i kësaj i qe shuar nga kujtesa; ajo që i kishte ndodhur, sikur kishte hapur një humnerë që e ndante nga jeta e mëparshme, ngjarjet e së cilës kishin rënë në një errësirë të turbullt harrese) dhe që atë ditë, prej turpit, kishte ikur nga fshati, kishte udhëtuar mjaft dhe bredhur gjithandej, derisa në fund kishte ardhur te kjo kishë si një shërbyes i devotshëm i priftit.

Shpejt do ta zëjë gjumi, përsëriti ai me vete fjalët e infermieres dhe trupin ia përshkoi edhe një herë, ngadalë, ndjenja e dyfishtë.



Kishte kaluar mesi i natës. Infermierja rrinte pranë të plagosurit, që nuk po vazhdonte më përçar-tjen e tij, ndërsa Martini ishte ulur mbi krevatin tjetër dhe diç po mendonte.

— Nuk e kisha për vete, — foli ai i pari, duke thyer heshtjen e gjatë, — nuk bëhesha shumë merak për veten time, kur thashë se s'duhej të hynim në kishë.

— As unë nuk ta mora ashtu, — tha infermierja. — Nga një anë kishe të drejtë kur the se mund të na kapin të gjallë.

Ajo u afrua edhe më tek i plagosuri dhe i vuri dorën mbi ballin e ftohtë.

— Kishte diçka të ligë në fytyrën e priftit, — vazhdoi pas pak Martini, — nuk e vure ré?

— Sesi më duket këtu në kishë, — tha ajo. Martini shau nëpër dhëmbë.

Vajza qeshi. Martini u ngrit nga krevati dhe, pasi qëndroi një copë herë ashtu, doli përjashta.

Duke ecur në korridor, u gjend përpara një dere të vogël të hapur përgjysmë. Brenda kishte rafte me libra të trashë, me kapakë kartoni, që dukeshin si të mbërthyer në rafte, si vazhdim i dërrasës së tyre. Pranë dritares që ulur prifti, me një libër në dorë.

Kur hyri Martini, ai ngriti kokën menjëherë, si i zënë në befasi.

— Po këtu, çfarë ka? — pyeti Martini me dyshim.

Ndërkohë skuadërkomandanti kishte zbritur posthë për të parë se si venin punët. Infermieren e gjeti në dhomë.

— Si është tani? — e pyeti.

— Çka, më mirë, por kam frikë se mos është e përkohshme...

— Ou!? — ia bëri skuadërkomandanti me habi, kur vuri ré se Martini nuk gjendej aty. — Po Martini ku është?

— Nuk e di ku vajti, — tha vajza, disi e shqetësuar. Skuadërkomandanti doli përsëri. Në fund të korridorit, pranë një porte, dëgjoji zërin e priftit, të cilin e kujtonte mirë; mundi të dallonte fjalët «violencë», «invazor» dhe mori me mend që ai po i thoshte Martinit se feja nuk e përligjte pushtetin e forcës dhe se ai nuk i donte pushtuesit.

Hyri brenda menjëherë. Prifti buzëqeshi si i lehtësuar, ndërsa Martini bëri një gjest nervoz dhe për disa çaste të tre mbetën në heshtje. Skuadërkomandanti vështroi priftin, pastaj Martinin, sikur i thoshte këtij të fundit: ç'merresh me të! Sakaq Martini u largua, ndërsa skuadërkomandanti qëndroi pak aty, duke vështruar me mospërfillje fytyrën e palëvizur të priftit, që i përngjau me një maskë metalike. Prifti përpiqej me zor të bënte sikur nuk po vinte ré asgjë.

Të dy partizanët kaluan nëpër korridor, duke shkuar për te dhoma e të plagosurit. Vetëm atëherë prifti thirri: «Klio!».

*
* *
*

Në murin e qelës dy hije qëndronin përballë njëra-tjetrës. Një prej tyre lëvizte kokën ngadalë, ashtu siç e lëvizin nganjëherë disa njerëz kur flasin, pastaj ngriti dorën. Hija tjetër u përkul, u drejtua përsëri, rrëshqiti mbi mur, mbi raftet e librave dhe arriti te dera, ku u zhduk.

*
* *
*

Skuadërkomandanti po ngjiste shkallët e kambanores. Anash tij vareshin deri poshtë në tokë litarët e kambanave, si disa gjarpërinj të mëdhenj.

Kur arriti pranë majës, padashur ktheu sytë mbi një frëngji të ngushtë, nëpër të cilën zhurma e erës, në ndryshim nga vendi i hapur pak më sipër, ku dëgjohej si një ulërimë e thellë, e zgjatur, aty vinte e mprehtë, si klithmë, dhe frëngjia e ngushtë ngjante si një gojë e hapur në mur, prej së cilës mund të dilte vetëm një klithmë e tillë. Ai u afrua dhe vërejti përmes saj diçka që i tërhoqi vëmendjen: dikush ikte me vrap nga kisha, hera-herës duke kthyer kokën prapa dhe duke vështruar gjithë frikë. Njohu Klion, shërbyesin e priftit. Ai vraponte me shpejtësi, nganjëherë pengohej diku dhe binte, ngrihej përsëri, kthente kokën prapa, dhe përsëri niste vrapin. Nuk ndodhej larg, megjithatë skuadërkomandanti nuk shtiu, po zbriti me nxitim, kaloi nëpër labirinte tërë kthesa dhe shpejt u gjend në dhomë.

— Shpejt... duhet të mos humbasim kohë, — u tha shokëve me një frymë.

— Pse... çfarë? — pyeti infermierja.

— Pashë atë, shërbëtorin e priftit të ikte me vrap. Mbase për të lajmëruar karabinierët. Por si-
doqoftë... Hajdeni, shpejt!... Nuk kemi kohë.

Ndërkaq, bashkë me infermierën, kishin kapur tezgën e të plagosurit. Ata u drejtuan për andej nga kishin ardhur në fillim, ndërsa Martini mori automatikun rrëmbimthi dhe shkoi nga ana tjetër.

Në qelë nuk e gjeti priftin. As në disa prej dhomave të tjera. Prifti, sikur ta kishin përpirë muret e kishës, kishte humbur diku midis tyre, si të mos kishte qenë gjë tjetër, veçse një fantazmë që zhduket dhe rishfaqet papritmas. Në qelë kishin mbetur vetëm raftet me librat e pluhurosur, gjithë ai grumbull letrash, mbushur me fraza të stërgjatura latine, të shtrira si kufoma dhe me kapakë të rëndë si kapakë qivuresh...

Shokët i arriti në sallën e madhe. Ata po kalonin në një si platformë që ndahej prej saj nëpërmjet një parmaku dhe një sërë kolonash mermeri. Megjithëse në sallë tani ishin ndezur gjithë qirinjtë, dhe ornamentet e shumta në gjithfarë formash të përdredhura (çuditërisht, çdo gjë që shihje në atë sallë, të jepte idenë e një rrotullimi dhe përdredhjeje) shkëlqenin me një refleks të zbehtë, kubetë e njëpasnjëshme anësore, mbi kokat e tyre, mbeteshin të errëta dhe të zymta. Dukej sikur në çdo çast, nga ndonjë prej afreskeve biblike mund të dilte fantazma e priftit, apo e paraardhësve të tij të vdekur, të nxirrte syrin ose të zgjaste duart poshtë për t'u prerë rrugën.

Ndërkaq ata kishin arritur në fund të kolonadës dhe ishin duke dalë nga salla. Martini u kthye dhe një herë, edhe të tjerët qëndruan dhe kthyen ko-

kën. Në heshtjen e rëndë, ku gjithçka sikur shndërruhej ngadalë në gur, u dëgjua një breshëri e gjatë automatiku. Tyta e automatikut të Martinit, duke nxjerrë flakë, përshkoi një hark, pastaj ndaloi.

Plumbat ranë mbi radhët e bankave ku përgjunjeshin besimtarët gjatë përshpirtjeve të tyre pambarim, mbi vendin e ngritur ku predikonte profiti, nga vinte valë-valë zëri i tij mbi kokat e ulura të besimtarëve, mbi vendin e psaltëve, mbi ornamentet. Copa xhami të thyera u përhapën mbi dysheme, shandanë të vegjël, cifla mermeri. Disa prej plumbave goditën më sipër një kryq të madh, duke i thyer fundin në një mënyrë që ai tani ngjante së largu si thikë. Plumbat që ranë më afër, zunë një statujë bronzi të shën Mërisë, prishën bazamentin prej gipsi, dhe ajo u rrëzua përtokë. Hija binte mbi fytyrën e saj të bronzët, me shikimin e kthyer anash, në drejtim të partizanëve dhe, atë mëshirën e zakonshme që gjen në fytyra shënjtorësh, e kishte zëvendësuar një shprehje e ftohtë, cinike.

Skuadërkomandanti, që s'ia kishte ndarë sytë Martinit dhe e kishte ndjekur në çdo lëvizje të tij, tundi njëherë kokën, pastaj tha:

— Të ikim tani.

Nuk pritën më dhe dolën. Porta e rëndë u mbyll pas tyre, si ta kishte shtyrë një dorë e padukshme.

*
* *
*

Ata u larguan me hapa të shpejtë, por duke u përpjekur që i plagosuri të mos tronditej. Asnjëri nuk fliste, asnjëri nuk e kthente kokën.

Konturet e kishës po shuhen dalngadalë. Pak më vonë ato do të zhduken krejt, do të treten në masën uniforme të errësirës. Dhe nga kisha do të mbetet një kujtim i humbur, një reminishencë e largët kohërash të perënduara.

Kisha nuk dukej më.

DUKE U KTHYER

Ata të dy po ktheheshin nga Sharrat.

Bënte nxehtë dhe qielli ishte disi i zbardhur nga vapa.

Astriti ecte pa folur, me një shprehje vetësigurie në fytyrë. Tjetri që Genci, mësuesi i ri i fshatit, i cili gjithashtu ecte pa folur.

Shtëpitë e para të fshatit ishin mbrapa një kodre të zhveshur dhe, për të arritur atje, duhej të kryenin një gjysmë rrethi përpara saj. Ishte qetësi, vetëm hapat bënin një zhurmë të butë, si të përgjumur. Ktheheshin nga Sharrat dhe pjesën e fundit të rrugës po e kalonin në heshtje. Genci kishte një ndjenjë të qëndrueshme gëzimi dhe kënaqësie. Në fillim kjo ndjenjë kishte qenë e vogël, e brishtë, gati-gati e papërfillshme. Por pastaj ajo që rritur dalngadalë, këmbëngulëse, derisa kishte zënë vend mirë në tërë qenien e tij.

Sipër kokave, nëpër qiellin e zbardhur nga vapa, u kaloi nxitimthi një shpend, që u zhduk pastaj matanë disa shkurreve.

Pak përpara ata të dy kishin shuar një zjarr.

Flakët qenë shfaqur befas, pa u kuptuar në ç'mënyrë, pothuajse kishin mbirë nga toka: ato shumoheshin e hidheshin në një vallëzim të marrë

nga njëri dru te tjetri, në fillim te disa drurë të vegjël... gjithmonë e më tepër dhe, duke zmadhuar shtatin, ata synonin drejt pemëve të mëdha të pyllit...

Pak a shumë këtë gjë po kujtonte Genci ndër-kohë. Ndoshta edhe tjetri. Genci ktheu kokën. I hodhi një vështrim të shpejtë me bisht të syrit. Kushedi, ndoshta, tha me vete.

Në trajtat e fytyrës së tjetrit, anash dhe në cepat e syve, të buzëve, poshtë flegrave të hundës, në gropëzën e mjekrës, në gropëzat e faqeve, nëpër rrudha që mpiksur heshtja e tij e zakonshme, diçka statike, me mundësinë për të qëndruar aty një kohë të gjatë.

Kjo heshtje e shokut të tij nuk e mundonte mësuën e ri të fshatit, i cili tashmë që ambientuar me të.

Për më tepër, tani ai po përtypte ngeshëm në trurin e vet atë rezervë të madhe kënaqësie që i kishte krijuar përpjekja jo e kotë e shuarjes së zjarrit. Fundi i xhakëtës që përzhitur paksa, gjë që ia bënte më të kapshme, më shqisore idenë e mundit të tij. Ai kishte përshtypjen se puna që kishte kryer, përbënte një akt afirmimi të vetvetes, ndoshta më të rëndësishmin në jetën e tij deri tani. Kjo përshtypje vinte gjithnjë e më shumë duke u qartësuar, duke u përforcuar.

Filloi të frynte erë, e cila tundte paksa degët e pemëve anës rrugës.

Vështronte hera-herës Astritin dhe i dukej se një pjesë e vetësigurisë së tjetrit po kalonte tek ai.

Pra, gjithë ajo që ndiente, kishte të bënte, në fund të fundit, deri në një farë mase, me afirmimin e personalitetit. Sikur të merrej vesh shmangia e

zjarrit, ai do të fitonte një besim më të madh të banorët e fshatit, nxënësit dhe prindërit e tyre. Do t'u fitonte besimin si njeri, në radhë të parë dhe, për pasojë, kjo do të ndikonte gjithashtu në punën e tij si mësues. Do ta falënderonin, do ta lavdëronin në kryesi të kooperativës, ndoshta edhe në seksionin e arsimit.

Kishin mbetur edhe disa qindra metra deri të shtëpitë e para të fshatit. Ata gjendeshin prapa kodrës gjysmë të zhveshur dhe prej andej pylli nuk dukej.

Genci vetëm atëherë u kujtua për një gjë kaq të thjeshtë, të cilën nuk e kishte vënë re, ndoshta sepse kishte qenë i përpirë nga hamëndjet e shumta: pra, në fshat dikush duhej ta tregonte. Vetë nuk do ta tregonte kurrsesi. Kjo do të qe, po t'i quanim gjërat me emrin e tyre, vetëmburrje.

Pak a shumë këto shqetësime i vërtiteshin Gencit nëpër kokë si ré të murme. Ndërsa qielli ishte i bardhë nga vapa, disi i zbrazët. Një shpend kaloi mbi kokat e tyre. Genci vështroi përsëri nga Astriti. Këtë radhë iu duk më hijerëndë. Astriti nuk mund ta tregonte kurrsesi, ai ishte pothuajse gjithmonë i heshtur.

Ishin njohur disa ditë pasi Genci kishte filluar punën në fshat. Astriti ishte mekanik i sharrave. Genci nuk e kuptonte se çfarë e kishte afruar kaq shpejt me këtë njeri fjalëpakë dhe në përgjithësi të zymtë. Ndoshta shkaku kishte qenë se ai përngjante mjaft mirë me imazhin që i ishte krijuar Gencit në mendje për punëtorët, në fëmijëri, deri në periudhën e shkollës tetëvjeçare.

Më pas ai kishte njohur punëtorë që ndryshonin krejt nga ky përfytyrim i dikurshëm. Por tani,

kontakti me këtë njeri, që, me sa dukej, kishte kaluar gjithfarë përplasjesh në jetë, kishte qenë i menjëhershëm...

Ai nuk do t'ua tregonte fshatarëve. Kjo heshtje me diçka prej muri bënte që ai t'i dukej Gencit tani si një farë gjykatësi, ndërsa Genci vetë-disi i veçuar përkundrejt këtij muri heshtjeje, përkundrejt Astritit dhe banorëve të fshatit. Disi i veçuar, gati-gati me një ndjesi të akullt faji.

Ishte pra e qartë se nuk duhej të tregonte. Diçka e bëri të ngjethej, i vinte inat me veten. Si kishte arritur qoftë dhe ta mendonte një gjë të tillë.

Madje, ndoshta ajo që patën kryer, mund të mos kishte ndonjë rëndësi kushedi se çfarë. Ndoshta rreziku nuk qe aq i madh, por ai e zmadhonte në mendjen e tij. Mundet që flakët të mos e kapnin fare pyllin, por të digjeshin vetëm kaçubet e thata që kishin shuar ata.

Jo, as kjo nuk ishte, mendoi Genci. Këtë ia pohonte vetes që të shpëtonte nga tundimi. Pylli vërtet mund të merrte flakë, sepse dëborë e kishte zënë shpatin pjesë-pjesë. Pastaj djegia e pyllit do të kishte pasoja të tjera, shpyllëzimi i atij shpati mund të sillte përmbytje të herëpashershme në arat që shtriheshin te këmbët e tij. Këto ara ishin hambari i kooperativës më të mirë të rrethit.

Pra, ishte diçka jo pa rëndësi.

Po të merrej vesh kjo, puna mund të vinte deri aty, sa për mësuesin e ri të fshatit të shkruanin gazetën, të fliste radioja, për aktin e tij prej qytetari të ndërgjegjshëm të organizoheshin mbledhje të ndryshme. Ai mund të bëhej shembull, objekt për propagandë, iniciativa, dhe kështu do t'i shërbente prapë në një farë mënyre shoqërisë.

Diçka e bëri të ngjethej përsëri. Iu kujtua një ish-fqinji i tij, i cili s'linte rast pa vënë gjithë dekoratat dhe stemat që kishin marrë njerëz të farefisit. Gjithmonë kishte ndier neveri për të. Tani ndien edhe për veten.

U dukën shtëpitë e para të fshatit. Mbas disa minutash mund të takoheshin me dikë, që mund t'i pyeste. Genci vështroi rishtas fundin paksa të përzhitur të xhaketës.

Mjaftonin vetëm disa fjalë dhe ai mund të bëhej shembull, mund të lavdërohej nga kryesia e kooperativës, nga Komiteti Ekzekutiv i Rrethit, ndoshta dhe mund të dekorohet nga Kuvendi Popullor.

Në hyrje të fshatit po vinin përkundrejt tyre një grup njerëzish.

U përshëndetën dhe ndaluan.

Genci priste që ata t'i drejtoheshin më parë tjetrit. Ndoshta kështu mund të ndodhte, në qoftë se njëri prej tyre nuk do të kishte vënë ré papritur fundin paksa të djegur të xhaketës.

— Ku e ke djegur kështu? — e pyeti fshatari, pasi bëri një pauzë për disa çaste. Pikërisht kur u mat të hapte gojën e të thoshte diçka, diçka sa për të mos mbetur ngushtë, qëllloi që foli Astriti:

— Ja, andej, — u përgjigj gjysma-gjysma, shkurt, si zakonisht.

NË KORIJEN E LISAVE

Kazma dha një tingull të ndryshëm.

— Kujdes, — tha burri i gjatë me syze dielli dhe me mëngët e këmishës të ngritura deri në bërryla.

— Kujdes, — foli prapë, me zë të ulët, arkeologu Mërkur D. Ai u përkul pak, si për të dalluar diçka, pastaj u ul në gjunjë dhe zuri të gërmonte me një thikë në vendin ku kishte goditur kazma herën e fundit. Ata qenë përkulur të tërë, duke këqyrur atë copë vend ku pritej të shfaqej mermeri. Edhe tjetri nisi të gërmonte me një copë hekur të mprehur në njërin skaj në formë konkave. Kaluan disa çaste dhe pas heqjes së një shtrese dheu ata dalluan dorën e mermertë të një statuje. Fotografi u afrua dhe shkrepri aparatin. Duhej gërmuar ende, sepse vetëm nga dora nuk mund të kuptohej pozicioni i statujës, të merrej me mend se ku gjendeshin për afërsisht pjesët e tjera të saj. Veglat për heqjen e dheut përdoreshin me kujdes të madh, në mënyrë që të shmangej çdo dëmtim sado i vogël që mund t'i bëhej statujës. Pas pak filloi më në fund të dilte kyçi i dorës, parakrahu. Fotografi shkrepse gjithnjë aparatin.

— Qenka në pozicion të pjerrët, — tha Mërkuri, duke ngritur kokën.

— E përmbysur, — tha një arkeolog i ri.

Këmbët e statujës duhej të qenë pak më sipër nga niveli deri ku kishin gërmuar, ndërsa poshtë, disa pëllëmbë në thellësi, në rast se nuk mungonte, duhej të qe koka e statujës.

U çuan prapë në këmbë. Arkeologu i tretë kapi kazmën dhe vazhdoi të gërmonte përreth. Pranë tij ishte një vajzë arkeologe, me sytë e rrudhur mjaft nga drita e fortë e diellit.

Mërkuri nxori nga xhepi shaminë dhe fshiu djersët. Frynte erë e lehtë. Në qiell kishte disa ré të vogla, të bardha. Mërkuri vështroi një copë herë kolegun e tij që gërmonte, pastaj dy-tre kureshtarët që kishin ardhur aty, me sa dukej nga fshati i afërt. Në qytetin antik tanimë nuk dëgjohej asnjë zhurmë, përveç disa pëshpëritjeve të shkëputura që shkëmbenin ata me njëri-tjetrin dhe goditjes së kazmës, në intervale të barabarta. Më tutje, midis rrënojave të mureve, mbi platforma të vogla, ngriheshin ca sonda të naftës akoma të paçmontuara. Disa muaj më parë, përpara se të zbulohej dhe të likuidohej grupi i sabotatorëve të naftës, aty qenë bërë kërkime. Dy prej tyre, sikurse edhe për disa zona të tjera ku kërkimet patën dështuar, kishin ngulur këmbë se ajo zonë përmbante naftë. Mërkuri, natyrisht, e kuptonte se nafta ishte më e domosdoshme nga gurët e vjetër, kolonat, apo varret ilire, por si zgjidhje më e përshtatshme i dukej që punonjësit e naftës duhej të merreshin vesh më parë me arkeologët, në mënyrë që të ruheshin monumentet, aq sa ishte e mundur dhe pa u bërë pengesë në punë. Por një mbasdite kishin ardhur aty buldozerët dhe kishin shkatërruar shpejt e shpejt një pjesë të madhe të objekteve të lashta,

që sapo ishin rinxjerrë në dritë. Mbas kësaj, dhe mbas ankesës që pat bërë instituti ku punonte Mërkuri, ata e kishin ndier veten ngushtë dhe qenë përpjekur të justifikoheshin: ... gabimisht... të na falni... të kishit ardhur që përpara, nuk do ta bënim... Në atë kohë ata Mërkuri i kishte quajtur me vete injorantë dhe mendjengushtë, por nuk i shkonte nëpër mend se kjo ishte pjesë e një veprimtarie armiqësore, të bërë me qëllim.

Ai që gërmonte, qëndroi disa çaste mbështetur në bishtin e kazmës, për t'u mbushur me frymë, duke vështruar poshtë tokën.

— Nëma, të vazhdoj unë, — tha burri i gjatë me syze dielli. Edhe ai e kishte ballin me bula djerse.

— Jo, — tha tjetri, — edhe pak kam...

Vegla dha përsëri timbrin e zakonshëm shurdhan. Trualli ishte rrëmor, deri diku i shkrifët, por i forcuar nga vapa e ditëve të fundit. Vinte në një ngjyrë midis bojëhirit dhe kafes.

— Edhe pak, — ia bëri duke nxjerrë duhmën ai me kazmë.

Më në fund, pasi larguan dheun dhe gërryen akoma me thika e qysqi, trupi i mermertë u duk i tëri. Ishte statuja e tretë që kishin nxjerrë atë ditë. Ato i gjenin, si përherë, në pozicione nga më të ndryshmet: vertikale, horizontale, pjerrtas, në brinjë, përmbys, kokëposhtë. Ndodhte që u mungonin gjymtyrë apo copa nga trupi. I shikon këto statuja? Pyetja përshkoi rrëmbimthi, si një bishë e kreshpëruar, trurin e Mërkurit, ndoshta për të njëmijtën herë në jetën e tij. Ajo lidhej me një rrafshultë të pluhurosur, me një mesditë me vapë, vite më parë. Atëherë ishte student në Histori-Gjeografi dhe gjatë verës, vitin e fundit të studimeve, kishte shkuar në

një ekspeditë të përbërë nga arkeologë shqiptarë dhe rusë. I shikon këto statuja? Qe një frazë e thënë me shqetësim, brenda saj gëlonte ankth. Si një copë pasqyrë, ajo risillte në kujtesën e Mërkurit pamjen e arkeologut të huaj, një rus trupmadh me flokë të zbërdhulët. Ja kështu, siç nxjerrim ne këto statuja, do të nxjerrin mbas njëzet-tridhjetë shekujsh të tjerë ato që do të mbeten nga qytetërimi ynë i sotëm, në rast se tani do të plasë një luftë bërthamore. Zëri kumbues në gjuhë të huaj, vendë-vende me fjalë që Mërkuri nuk i kuptonte, i përngjante një jehone të humbur, ishte gati si një profeci, një psalm, një predikim. Tërë kubeja e qiellit merr një ngjyrë sqfuri të ndezur, vazhdonte ai me një shprehje pothuaj vegimtare në fytyrë. Toka nxihet, lëkundet me egërsi dhe vjen pastaj një rroposje e madhe qytetesh, ishujsh. Kontinente të tëra të mbuluara me kufoma, të shndërruara në hekatomba gjigante. Apokalipsis, apokalipsis... Pastaj mbi planet bie heshtja, menopauza eterne... Unë besoj, i pat thënë rusi një herë tjetër, disa ditë më pas, besoj në perëndinë, jam i krishterë. Megjithëse ty mund të të duket ca e çuditshme. Herë pas here ai i fliste prapë për shkatërrimin fatal të bombës atomike. Midis arkeologëve rusë ishte edhe një grua e ré. Ajo tregonte interes për këto biseda të tij dhe me mënyra të ndryshme e nxiste. Tjetri rifillonte më me vrull, nuk kishte të ndalur. Ajo merrte atëherë një pamje solemne, të rëndë. Sytë e saj të mëdhenj hapeshin edhe më. Njëherë, disa vjet më vonë, Mërkuri e pat parë në një ëndërr: ishte një pejsazh i çuditshëm, me një relief të çrregullt, që nuk u bindej ligjeve të natyrës, e prapëseprapë formonte më në fund një figurë të rregullt, kreshta

që rrethonin një fushë, diçka si amfiteatër. Diku larg, në horizont, ku sapo perëndonte dielli, disa silueta të stërgjatura, edhe si ré, edhe si prej tymi, por që papritmas u shndërruan në statuja që bënin harakiri. Në mes të fushëtirës ngrihej paksa mbi të një skenë teatri dhe në mes të skenës një bombë e madhe, tre bojë njeriu ose më tepër. Arkeologia ruse, me një veshje-butaforti, ngacmuese për mashkullin, kishte hapur krahët dhe qe puthitur pas syprinës së bombës. Nga fundi i skenës ulej e ngrihej një kor i padukshëm Sibilash. Arkeologia ruse hapte sa më shumë gjymtyrët e saj, në një përpjekje të mundimshme, të kotë, për të pushtuar tërësisht bombën. Ishte një nga ëndrrat e pakta që ai mban-te mend... I sheh këto statuja? Bomba atomike qe një ndër temat e shpeshta në bisedat e sovjetikëve. Ajo dilte aty-këtu, shfaqej befasisht nëpër dialogë, midis dendësisë së fjalëve apo hapësirave boshe të pauzave, si një makth që i mundonte, si një prani shpirtrash të këqinj. S'është gjë tjetër, vetëm dëshira për ta përdorur, i pat thënë kohë më vonë Merkurit një mik i tij, pedagog në Shkollën e Partisë... Kori i Sibilave. Kohët e fundit ata e përmendnin gjithnjë e më dendur. Në ekspeditë bënte pjesë edhe një etnograf apo gjuhëtar, — Merkurit nuk e mbante mend me saktësi, — i cili kishte mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik. Ai u vërtitej ruseve me një përrulje që binte shumë në sy, ku kishte diçka prej adjutanti, përzier me diçka të përcudnuar, me diçka nga dhënia e vetvetes. Ai gjallërohej veçanërisht kur binte fjala për një luftë të mundimshme në botë. Bashkimi Sovjetik, kreu i kampit socialist, ka një potencial shumë të madh bërthamor, përsëriste hera-herës ai, gati i ekzaltuar. Ar-

keologu rus e dëgjonte me një pohim të heshtur, me një farë vetësigurie, por ndonjëherë, jo rrallë, i përgjigjej i nervozuar, duke fshehur keq një sizmë të largët paniku. Shumë armë ka, kishte thënë një ditë, ndërsa po nxirrnin nga një varr i hapur armë ilire prej bronzi. Atëherë ishin diku në veri të Shqipërisë, në një luginë që futej thellë midis maleve. Gërmonin pranë grykës së një miniere; matat e maleve, në formë dhëmbësh, krijonin një konfiguracion të vjetër sa bota. Shumë armë ka, kishte thënë arkeologu rus, si i tronditur, si me habi. Kori i Sibilave. Bashkimi Sovjetik, kreu i kampit socialist, ka një potencial... Në vitet e mëpasme Merkurit nuk i kishte qëlluar më ta takonte dendur. Ky njeri kishte ndërruar qendrën e punës dhe për disa kohë kishte punuar në një dikaster tjetër. Por njëherë pat ardhur aty një grup i kontrollit punëtor; mbas katër ditë dhe net mbledhjesh, u shkurrtuan disa zyrtarë, ndërmjet tyre edhe ai, ish-etnografi apo gjuhëtari, të cilin e zhveshën nga funksionet zyrtare për burokratizëm. I sheh këto statuja? Ja kështu, siç nxjerrim ne këto statuja, do të nxjerrin mbas njëzet-tridhjetë shekujsh të tjerë ato që do të mbeten nga qytetërimi ynë i sotëm. Ne sot përpiqemi të interpretojmë, të gjejmë se çfarë janë objektet e lashta që zbulojmë. Ja, kështu do të zgjidhin stërnipërit enigmat e fosileve të shekullit tonë. Mund të ndodhë që ata të ngatërrohen mbase edhe në sende fare të rëndomta, koburja dhe doreza metalike e dritares mund t'u duken njësoj të pafajshme. Kur të zhvarrosin karkasat e hekurta të uzinave të dikurshme, distilerve, eshtra kompleksesh siderurgjikë, stërnipërit do të pyesin veten: për çfarë kanë qenë përdorur gjithë këto? Mbase edhe do

të mahniten ndopak me zhvillimin e teknikës së pa-
raardhësve të tyre të largët, por nuk do të arrijnë
kurrë të kuptojnë se pikërisht aty, në ato rrënoja
madhështore, ka qenë ngjizur plazma e kësaj kata-
strofe... Ky ankth i herëpashershëm në bisedat e
tyre dilte jo rastësisht, tha me vete Mërkur D. Ishte
një avatar i madh i dëshirës së supershtetit për ta
përdorur bombën. Orvatja për ta nxjerrë përthy-
hej, copëtohej në jehona të panumërta, përsëritej e
përsëritej vazhdimisht si një formulë magjike nga
qytetarët e supershtetit. Por nuk kishte kaluar shu-
më dhe ai e kishte nxjerrë: pas Mbledhjes së 81
Partive në Moskë, menjëherë kishte filluar blloka-
da, ikja e specialistëve të vendeve të Paktit të Var-
shavës, prerja e kredive, ndihmave ekonomike...
Ishte e njëjta gjë. Ata po ndërmerrnin, më në fund,
përfitim të shkretëtirës në vendin e vogël në jug-
perëndim të Ballkanit, ta kthenin atë në një dje-
rrinë të dystuar nga vdekja, me një heshtje sovrane
mbi të, vetëm tek-tuk me grumbuj gurësh e heku-
rishtash si simbole vendbanimesh të dikurshme.
Goditja që bërë me egërsi, e pakursyer. Përkohë-
sisht diçka u thye, diçka tjetër pak më tutje mbei
pezull, diçka tjetër ndaloi së ecuri. Ndërkohë inxhi-
nierët e huaj largoheshin njëri pas tjetrit, duke ma-
rrë me vete, në çantat e tyre, projekte, dokumente
pune; ata ikin si fantazma, ndërsa e vetmja gjë so-
lide dhe e prekshme ishin çantat e zeza në duart
e tyre, gjithfarë çantash, bojë kafë, të zeza, të mur-
me, me zinxhirë, me susta, plastike, të meshinta; ik-
nin në disa drejtime, drejt hapësirave me mjegull
të Evropës Qëndrore apo të Euroazisë. Makineri të
ndryshme pritej të vinin prej andej, por nuk erdhën
asnjëherë, me sa dukej qenë përpirë nga masa shfa-

rosëse e mjegullave, së bashku me projektet... Goditjen më tepër e kishin ndier mjetet lëvizëse. Por kjo kishte qenë vetëm përkohësisht. Në fillim me vështirësi, mes dhimbjesh, por pak nga pak, gjithnjë më e sigurt dhe e plotë, lëvizja kishte arritur të ruhej, të mbijetonte. Afërsisht në atë periudhë, në vitet 62, 63, Mërkur D. bënte stazhin e Partisë në një uzinë për pasurimin e bakrit, kështu që kishte mundur ta shihte mirë këtë ndeshje me statizmin, me palëvizshmërinë absolute, me ngurosjen statujore të gjithçkaje. Në kovat e vogla të konvejerëve metali i shkrirë ngjante si magmë verbuese. Njerëzit, me syze të errëta mbrojtëse dhe me hekura të gjatë nëpër duar, ruanin natë e ditë që të mos shuhej lëvizja. Klasa punëtore është klasa pararojë... Te ne pushteti i përket klasës punëtore... Heroizmi i klasës punëtore... Që më parë Mërkuri i kishte dëgjuar mjaft herë këto fjalë dhe i kishte pranuar si fakte të mirëqena, por, në të vërtetë, pa u ndalur gjatë në kuptimin e tyre. Vetëm tani, në vitet që kishte punuar në uzinë, ai ishte në gjendje t'i prekte me dorë dhe t'i shihte të sendëzuara ngado përreth tij.

Burri i gjatë me mëngët e këmishës të ngritura deri në bërryla, që pak më parë kishte marrë kazmën nga arkeologu tjetër, ndaloi së gërmuari, pastaj futi duart në xhepa si për të kërkuar diçka.

*
* *
*

Dalngadalë po afrohej muzgu. Në qytetin antik vazhdonte të frynte një erë e lehtë. Ata fshinin

me disa furça statujat prej mermeri, hiqnin dheun që u qe ngjitur aty-këtu. Por, për t'i pastruar më mirë, si dhe për t'u bërë ndonjë restaurim të vogël, ata duhej t'i merrnin me vete. Prandaj pas pak ata i vendosën statujat në karrocerinë e mbuluar të kamionit (nga spondi i mbrapmë, i lënë hapur, dukeshin pjesë-pjesë këmbët e tyre të bardha, ndërsa një amforë dhe disa copa tjegullash të mëdha i vunë në një arkë prej druri, në gazin shtatëvendësh).

Si mbaruan të gjitha këto, vajtën dhe u ulën për të pushuar pak te disa pemë në anë të vendbanimit të vjetër. Ishin dy lisa të mëdhenj. Era e lehtë tundte floknajat e tyre të gjelbra. Tutje në horizont, mbi konturet e buta të kodrave, po ulej shumë ngadalë disku i kuq i diellit. Ndrëçimi i tij krijonte mbi retë përçark diçka të ngjashme njëkohësisht me përgjakjen dhe tatuazhin. Mërkur D. po rrinte akoma në këmbë. duke pirë cigare. Çdo gjë i vinte në kokë lirshëm dhe me rrëmujë. Mbase ishte vetë kjo orë e ditës, që gjërat aq të largëta i afronte në mënyrë të pabesueshme... Njëherë kishte parë një film për historinë e dyndjeve të mëdha. I qe fiksuar imazhi i fillimit të filmit: tempuj, statuja, rreshta kolonash të bardha në një sfond të palëvizshëm blu të qiellit, pastaj erdhën befas, me shpejtësi e zhurmë, kuaj, kuaj, kuaj, kuaj. Gjithçka nisi të dridhej e të plasaritej aty-këtu nga troku i kuajve, si nga një tërmet. Dridhjet bëheshin përherë e më të fuqishme, derisa më në fund muret e tempujve, kolonadat dhe çdo gjë ra përdhe, u shpërbë në kokrriza të vogla pluhurore...

Mërkuri thithi cigaren. Mbi tavolinën portative një nga arkeologët kishte hapur një hartë topografike të zonës dhe po shënonte diçka me laps. Ai hiqte

ca vija të lakuara dhe i thoshte diçka një tjetri, të ulur pranë tij.

— Ky vend që shikoni këtu, — tha një nga fshatarët që nuk ishin larguar ende, krahu i nderur i të cilit përshkoi një gjysmërreth, duke treguar nga pjesa e fushës matanë një vijë uji që gjendej aty pranë. — ky vend që shikoni këtu vazhdon të quhet Korija e Lisave, megjithëse tani kanë mbetur vetëm këta dy lisa. Prapë nuk mbahet mend as nga më pleqtë, që këndeja afër të ketë pasur pemë.

Ai që fliste ishte një burrë fytyrëkuq, me rru-dha të shumta. Tregonte ngadalë dhe shtruar, me mjekrën mbështetur në grusht.

— Thua se janë prerë, — vazhdoi ai, — thua se janë shkatërruar nga zjarri... po, sidoqoftë, në kësi rastesh, së paku ndonjë shenjë se ka pasur korijs do të mbetej. Tani ka mbetur vetëm emri.

— Me sa duket, ka qenë shumë përpara, — tha arkeologu i ri.

— Ndonjë legjendë apo histori të vjetër në lidhje me këtë nuk ka?, — pyeti ai që punonte me hartën, duke ngritur kokën.

Fshatari u përtyp. Vështroi një copë herë nga Mërkuri.

— Jo, — tha mbas pak, duke lëvizur prapë dorën, — nuk ka. Ka mbetur vetëm emri.

Disku i diellit vazhdonte uljen e ngadalë drejt vijës me dredhime të ngathta të horizontit. Njëkohësisht me uljen tij, mpakej gradualisht, por me ngulm, hija e lisave.

Mërkuri vendosi mbi gjunjë dhe hapi një fletore të madhe të lidhur, me kapakë kartoni. Ishte fletorja me vizatime e një djali nga fshati aty afër, i cili kishte kaluar nga dreka, që ndaluar pak dhe

shihte me kureshtje se ç'bënin arkeologët. Ai qe një djalë rreth të pesëmbëdhjetave, i shkurtër dhe i dobët, me flokë të dredhur. Mbasi kishte kundruar disa minuta në heshtje, i qe afruar fotografit dhe e kishte prekur lehtë në sup. Mërkuri pat ndjekur me kujdes gjithë lëvizjet e tij të druajtura. Ai kishte nxjerrë nga çanta prej rrobe të zezë fletoren e trashë dhe ia kishte zgjatur fotografit, ndoshta ngaqë pamja apo veprimet e këtij të fundit e bënin më të komunikueshëm, ose, të paktën, më me interes në sytë e djaloshit... Fletorja përmbante vizatime zogjsh, pemësh, aty-këtu ndonjë portret, pastaj, në faqet e mëtejshme vinin vizatime me lapsa me ngjyrë, të bëra sipas modelit të disa mozaikëve të zbuluar aty. Figurat qenë përvijuar me kujdes dhe me një përpjekje për t'u qëndruar sa më pranë modeleve. Aty ku, me sa dukej, në mozaik kishte vende bosh a dëmtime, ai i kishte plotësuar vetë në fletore. Duke parë vizatimet, Mërkurit i erdhën në mend përsëri mozaikët e prishur, ose ata të zhdukur krejt. Sot po vinin përsëri mbas një viti dhe shumë nga mozaikët po i gjenin të shkatërruar. Mbi një pjesë të mozaikut më të bukur, me figura valltaresh, rëndonte njëri cep i bazamentit të sondës. Vështrimi i tij kishte kapur arkeologun e ri, Nikun, i cili dridhej i tëri nga zemërimi. Patën qenë aty së bashku, një vit të shkuar, atëherë kur ishte zbuluar pjesa më e madhe e mozaikëve të këtij vendbanimi. Për Nikun atëherë qe ekspedita e parë... Mërkuri u mundua të rikrijonte në imagjinatën e tij atë rrënim. Ai u përpoq disa çaste të merrte me mend gjithçka. Muaj më parë, atë mbasdite, mbi qytetin antik rrinte pezull një heshtje e rëndë. Dhe bashkë me heshtjen, qielli i përhimë, statik, me një

dritë të mugët diku thellë në të. Dukej sikur pllakat e gurta, shkallaret e amfiteatrit, kolonat, varret monumentale, ishin në një ankth të vazhdueshëm, prej shumë, shumë kohësh, aq kohë sa nuk mbahet mend. Dhe befasi nga një kënd i fushëtirës u ngrit një uturimë motorësh: ajo kaloi si një rrëqethje nëpër gjithë fushën. Heshtja e rëndë, e vjetër, po çirrej me dhunë. Buldozerët nisën të lëviznin nëpër qytetin antik si ca kafshë të mëdha, të ardhura s'dihej prej ku. Nofulla e vetme, e tmerrshme, merrte përpara me rrapëllimë gurët e vjetër, muret deformoheshin, mblihdeshin kruspull, përziheshin me dheun. Pastaj ra nata dhe aty mbetën vetëm disa pirgje dheu. I sheh këto statuja? Ishte e njëjta gjë: sabotatorët e naftës po përsërisnin të njëjtën gjë, rroposjen e statujave, si atëherë, në fillimin e Erës sonë, në kohën e dyndjeve. Vetëm se visigotët, ostrogotët, hunët nuk vinin mbi kuaj, por në trajtën e buldozerëve të mëdhenj...

Mërkuri uli vështrimin mbi fletoren e lidhur me kapakë kartoni. Në faqet e fundit kishte midis tyre gjethe të thara bimësh të ndryshme.

— Po ato çfarë janë?, — pyeti kalimthi një arkeolog, i cili u përkul një çast që mbrapa supit të Mërkurit.

— Gjethe... herbarium i vogël, — tha ky i fundit.

Burri i gjatë me mëngët e këmishës të përveshura deri në bërryla, kishte hequr syzet dhe i kishte futur në xhepin e përparmë. Ai po rrinte ulur në një nga stolat portativë prej mushamaje dhe vazhdimisht vështronte orën. Vajza rrinte në këmbë, duke mbajtur një transistor. Ajo lëvizi burmën një copë herë, pa e ndaluar gjatë në asnjë nga stacio-

net. Fotografi, ulur në gjunjë, pak i kërrusur, me rrej me disa zarfe. Mua më duket e çuditshme, ti si mendon? — thoshte pak më tutje Niku, arkeologu i ri. Arkeologu tjetër, te tavolina, palosi hartën me kujdes.

Po binte muzgu. Hija e lisave tretej ngadalë mbi tokë, sikur përpihej prej saj. Era e lehtë tundte floknajat e tyre të gjelbra. Gjethet jepnin një zhurmërimë të butë e të dridhshme. Ndërsa mbi qytetin antik ishte heshtje. Ajo dukej sikur kullonte nga skajet e qiellit bashkë me muzgun dhe zinte vend kudo. Asgjë nuk lëvizte. Mes fushëtirës ngriheshin konstruktet metalike të sondave, ca silueta të errëta, të ngjashme me obeliske apo me perëndi memece të panumërta. Ç'kishin kërkuar aty këto sonda, tha me vete Mërkur D., në përhumbje, nga kishin ardhur? Mos vallë kishin ardhur për të nxjerrë naftë? Por aty s'kishte naftë. Ato kishin qenë aty për të kërkuar nën tokë grada gjeneralësh e kolonelësh, granduniforma, stoli mbretërore, mantele dukësh, baronësh, vezirësh, nishane e vula perandorake, tapi të vjetra tokash, dëshmi dispozitash bankare. Errësira rridhte nga qielli si një lëng viskoz, i pikëzuar vende-vende nga yjet. Ajo thithte pareshtur drejt vetes siluetat e sondave. Ato i përhiheshin tani Mërkurit si pelegrinë që po iknin drejt errësirës, po largoheshin drejt trojeve të tyre. Pelegrinë të përzënë. Më vonë ata mund të riktheheshin nga ai shteg ose nga shtigje të tjera. Po prapë do të iknin të mundur, si para një viti, si atëherë, në 60-n, në 61-shin, si atëherë, para dy mijë vjetësh. Gjithmonë.

INSTRUMENTI

Në luginën e ngushtë të rrethuar nga pemët, zjarret tashmë ishin ndezur. Partizanët, me batanije të vjetra hedhur supeve, qëndronin rreth tyre ose endeshin lart e poshtë. Një lëvizje dhe gumëzhitje jo e zakonshme kishte përfshirë atë natë gjithë fushimin. Vetëm atje ku mbaheshin robërit, nuk kishte lëvizje.

Atë ditë, aty nga dreka, kapën një oficer gjerman, që vinte nga Greqia për të sjellë një instrument torture të një lloji të ri, të përdorur ndonjëherë në vendin tonë. Thoshin se ishte i tmerrshëm, megjithëse i thjeshtë si ndërtim; përbëhej nga katër këmbëzat, të bashkuara dy e nga dy si ikse, të cilat lidheshin me njëra-tjetrën nëpërmjet disa traversave, të gjitha të fiksuara, veç njërës, që rrotullohej rreth vetes. Në njërin skaj kishte një manivelë, ndërsa tjetri përfundonte me një si majë të rrumbullakët dhe të filetuar. Mbi njërin prej traversave që shkruar diçka me shkronja gotike. Në pamje të parë ai nuk të linte përshtypjen e një instrumenti torture dhe nuk ishte në gjendje ta kuptojë se si mund të përdorej për atë qëllim. Por oficeri gjerman duhej të dinte ta përdorte, në të gjitha mënyrat e mundshme.



Në mbrëmje vonë numrit të robërve iu shtua dhe një tjetër. Nga pjesa veriore e fushimit erdhën tre ilegalë të qytetit, të shoqëruar me partizanë. Mes tyre ecte një burrë me pallto dhe borsalinë, që i kishte duart të lidhura mbrapa, ndërsa njëri prej ilegalëve hera-herës e shtynte lehtë. Pas pak arritën te vendi i robërve. Aty gjendeshin disa gurë të mëdhenj të bardhë, në njërin prej të cilëve rrinte ulur gjermani, i kthyer me fytyrë nga instrumenti, që e kishin lënë aty pranë. Robit tjetër ia zgjidhën duart, duke e urdhëruar që të ulej edhe ai. Pastaj ilegalët shkuan te komandanti.

Rrugës, duke kaluar përmes partizanëve, u zuri veshi aty-këtu ndonjë fjalë për robërit, për oficerin gjerman dhe për atë që sapo e kishin sjellë. Ky i fundit ishte tregtar i pasur, një nga më të pasurit në qytet, i cili kishte hyrë në shërbim të Gestapos. Ata të tre e kishin kapur dhe e kishin sjellë nga qyteti fshehurazi. Natën do ta kalonin në fushim, kurse të nesërmen do të ktheheshin përsëri në qytet.

Të ardhurit arritën te një zjarr i madh, pranë të cilit, bashkë me të tjerë, që ulur komandanti. Kur i pa, ai u çua në këmbë dhe i përshëndeti.

— E prutë atë, domethënë, — tha komandanti, — po afrohuni, afrohuni, rrini këtu, pranë zjarrit... Keni ftohtë, ë?... Domosdo, jemi në mal.

Ata u afruan dhe nderën duart nga zjarri. Dru-të e mëdhenj digjeshin me një kërcitje të thatë, ndërsa gjuhët e flakëve sikur donin të përpinin errësirën.

— Po mirë, a ju kundërshtoi shumë kur e kapët?, — pyeti komandanti.

— Jo... nuk kundërshtoi. Shokët e kishin sajuar shumë bukur, në mënyrë të përsosur, dhe ajo që na mbetej neve, ishte një gjah i thjeshtë, — tha njëri nga të ardhurit me një shprehje të papërcaktuar në fytyrë, midis seriozitetit dhe qeshjes. Ky, si duket, ishte përgjegjësi i të treve, sepse vazhdoi të bisedonte me komandantin duke i raportuar shkurt për spiunin që kishin kapur. Ai i tregoi për informatat që kishte dhënë spiuni i Gestapos, për dëmet që u kishte sjellë komunistëve të qytetit, për shokët e humbur, për ata që torturoheshin nëpër qelitë e burgut...

*

* * *

Spiuni ishte ulur pranë oficerit gjerman dhe diç i thoshte. Kishte hequr pallton, ishte ulur mbi të dhe tani i dukej kostumi i mirë që mbante veshur, ndërsa gjermani rrinte i kthyer pak mënjanë, pa iu përgjigjur dhe vetëm sa i hidhte ndonjë vështrim të ftohtë, si të donte ta largonte.

— Dëgjomëni mua, — lutej spiuni, — tregojani këtyre funksionimin e instrumentit... Ju siguroj se do të jetë më mirë për ne...

Gjermani vështronte me përbuzje dhe me një farë talljeje. Fytyra i mbetej si e ngurosur. Ai ishte aty i vetmi që dinte ta vinte në punë instrumentin, dhe kjo i krijonte iluzionin e një farë superioriteti, ndërsa partizanët, mendonte ai, këta fshatarë të zymtë, të vrazhdë dhe injorantë duhej të qëndronin

me habi përpara instrumentit, si përpara një qenieje të pashpjegueshme, enigmatike... dhe kjo habi mund të kthehej në adhurim, siç kthehet në adhurim frika ndaj zotit, mendonte ai.

E ku ta dinte ky njeri që kishte përpara, se ç'do të thoshte të ishe i vetmi që zotërojë sekretin e instrumentit.

Spiuni mbështeti pëllëmbët mbi tokë dhe, duke ecur këmbadoras, i erdhi atij rrotull, në mënyrë që t'i dilte përballë, ndërsa kravata i varej poshtë si peshk i ngrirë. Iu afrua te veshi dhe i tha me zë të ulët, po duke folur shpejt, sikur donte t'i rrufiste fjalët sapo i thoshte:

— E dini? Këta nuk ta bëjnë shumë të gjatë. Nesër në mëngjes na vrasin të dy. Nuk e kanë zakon të mbajnë robër.

Gjermani kreu një lëvizje të menjëhershme, impulsive, por u përmbajt dhe prapë shtangu. Tani ai e vështronte më me zemërim, por, megjithatë, si duket, tani nuk mund ta përzinte, sepse ia kishte nevojën për diçka, për një farë sqarimi. Spiuni e kuptoi se një gjë kishte ndryshuar, se po vinte çasti që të luante gurët e fundit dhe pas pak, ndoshta, do të arrinte atje ku donte.

— Po qe se nuk tregoni, — tha ai, — edhe instrumentin kanë borxh ta zhdukin që nesër...

E pamundur! Jo, deri këtu jo! Kjo do të ishte me të vërtetë katastrofë! Oficeri gjerman e dinte se do të merrte dënimin më të rëndë, megjithatë në thellësitë e mendjes ruante një shpresë të vagët, se partizanët nuk do ta ndëshkonin, pa e kaluar në procedurë normale gjyqësore, nga e cila edhe mund të shpëtonte, një shpresë e zbrazët sigurisht, këtë e pohonte edhe vetë në ndërgjegjen e tij. Po s'pri-

shte ndonjë punë, edhe në qoftë se e vrisnin, sepse instrumenti nuk do të shkatërrohej, do të vazhdonte të ekzistonte midis atyre njerëzve të huaj, duke pasur mbi ta forcën magjike të së panjohurës. Kështu kishte menduar ai deri pak më parë. Mirëpo deri atë çast nuk e kishte ndier vdekjen aq të sigurt, aq të afërt, sa tani që kishte dëgjuar ato fjalë; i dukej sikur ajo prekte kudo, në gurët e bardhë, në bar, në uniformën e tij dhe sikur pak nga pak po i hynte përbrenda trupit, sikur qelizat po degjeneronin në një masë të turbullt, opake lëndësh inorganike. Aq më tepër, ai kishte mësuar se ata do ta shkatërrojnë edhe instrumentin, prandaj nuk kishte më pse ta mbante të fshehtë funksionimin e tij. Ndoshta, po ta tregonte, mund t'i siguronte jetë të mëtejshme vetes dhe instrumentit. Sidoqoftë, mendoi që spiunit të mos i thoshte asgjë deri të nesërmen në mëngjes, ngaqë nuk donte ta shihte të gëzuar. Ai e urrente.

— Mirë, mirë, — tha me zë, — të shohim deri nesër në mëngjes.

Spiuni u kënaq nga fitorja që arriti dhe vendosi të mos e nxiste më tepër oficerin, por ta linte që vetvetiu, deri në mëngjes, t'i kthehej mendja plotësisht. Ai i kishte dalë tani krejt përballë dhe qëndronte aty me një buzëqeshje të vazhdueshme në fytyrë, ndërsa tjetri vështronte mendueshëm gurët e mëdhenj; në dritën e hënës ata dukeshin akoma më të bardhë. Gjermanit i dukeshin si dhëmballë të tokës, që bëhej gati ta përpinte së bashku me instrumentin e torturës, ndërsa një gur i rrafshët i dukej si pllakë varri. Jo, mendonte ai pastaj, këta, po na vranë, mund edhe të mos na varrosin fare dhe eshtrat tona do të lëshojnë natën ndriçi-

min fosforeshent si këta gurë në dritën e hënës. Atëherë edhe instrumenti do të mbetet midis shirave dhe erërave gërryese; pak nga pak do të humbasë bojën, smaltin, mandej do të ndryshket, derisa më në fund të kthehet në një grumbull hekurish-tash.

*
*
*

...
— Nuk e dëgjova tamam se çfarë the.

— Ishte fjala për gjermanin.

— Si do t'i bëhet atëherë?

— Dikush tha se instrumentin do ta marrim nesër në marshim.

— Nuk e besoj. Sot isha pranë komandantit kur tha se s'kemi pse të mbartim pesha të tepërta.

— Dikush tha se do ta ruajmë, që më vonë ta çojmë në muzeum për ta parë brezat e ardhshëm...

— Ju që jeni atje, një çikë me zë më të ulët, po të doni. Fundja, mos rrini larg e larg, po afrohuni me njëri-tjetrin, se na latë pa gjumë!

— Si dëgjove ti?

— Dëgjova se do ta ruajnë për muzeum...

— Kushedi.

— Mbase duhet ta çojmë në shtab...

— Pse?

— Mbase për ta studiuar.

— Ose për të marrë një mendim se ç'duhet ta bëjmë.

— Edhe kjo mund të jetë.

— Pastaj, ç'na duhet të studiojmë një instrument që kanë përdorur gjermanët për torturë!?

— Ej, një çikë me zë më të ulët, se na latë pa gjumë, de!

— Dje pashë diku një fotografi të Marksit. . .

— Po?

— Lexova dhe diçka prej tij, që, të them të drejtën, në fillim e pata pak të vështirë ta kuptoja. Ai thoshte se ne nuk jemi për shoqërinë civile, po për shoqërinë njerëzore, apo për njerëzimin e shoqëruar, diçka e tillë.

— Domethënë, duhet të shkatërrojmë shoqërinë borgjeze dhe të ndërtojmë diçka të re, socializëm i thonë. . .

— Po, këtë ma tha edhe zëvendëskomisari. . . A biem të flemë tani, se i lamë shokët pa gjumë.

— Natën e mirë!

— Natën e mirë!

Të dy partizanët nuk folën më dhe u shtrinë të flinin.

Kishte kaluar mesnata dhe në fushim ishte qetësi. Vetëm dikush ishte ngritur dhe po shkonte ngadalë drejt vendit të robërve; ishte njëri nga ilegalët që kishin ardhur nga qyteti para disa orësh. Ai e kishte dëgjuar bisedën për robërit, për instrumentin e torturës dhe tani, meqë kishte ndenjur një copë herë shtrirë, pa e zënë gjumi, me kokën mbështetur në një çantë shpine, i shtyrë nga kurreshtja, po shkonte përsëri andej. Si oficeri gjerman, ashtu edhe spiuni po flinin, ndërsa instrumenti qëndronte pranë tyre si një qenie e përgjumur, e palëvizur, me katër këmbëzat të ngulura në tokë. Çfarë ëndrrash mund të shohë ky gjerman? — mendoi ilegal. Ndoshta tërë kohën ëndërron për vënien në punë të instrumentit, për torturat e ndry-

shme që mund të kryhen me të, megjithëse, kushe-
di, ndoshta e ndien se kësaj vegle i ka ardhur fundi.
Ilegali u përpoq të lexonte shkronjat gotike mbi
trupin e instrumentit, por nuk mundi, për shkak të
dritës së pamjaftueshme që vinte nga zjarret për-
reth. Shkronjat e visigotëve apo të ostrogotëve të
hershëm, mendoj ai. Pastaj u largua dhe sërish u
shtri të flinte. Në fushim ra qetësia. Siluetat e ro-
jeve lëviznin në gjysmerrësirë. Herë pas here ndo-
njëri prej tyre u afrohej zjarreve që ende nuk ishin
shuar dhe atëherë në fytyrën e tij, të ndriçuar prej
flakëve që luhateshin, krijoheshin gjithfarë reflek-
sesh.

*
* *
*

Ndaj të gdhirë kishte rënë një shi i shkurtër,
që i kishte zgjuar të gjithë. Kështu, partizanët do
të niseshin në marshim pak më shpejt nga ç'para-
shikohej. Ata po bënë përgatitjet e duhura, duke
rregulluar municionet, armët, batanijet e lagura, pa-
jimet e ndryshme. Ndonjëri që kishte mbaruar së
përgatituri, hante ndonjë kafshatë bukë.

Në këtë kohë një partizan njoftoi komandantin
se robi gjerman donte të fliste me të.

— Di gjë pse më kërkon?, — pyeti komandanti.

— Jo, vetëm tha se donte të bisedonte pak për
një gjë që, siç thotë, është shumë e rëndësishme.
Këtë ma tha ai spiuni që ma përkthente.

Komandanti tundi një herë supet dhe, bashkë
me atë që i kishte sjellë njoftimin, u drejtua për te
vendi i robërve. Aty ishin mbledhur edhe disa par-

tizanë të tjerë, të cilët, si dukej, donin të dinin se çfarë kishte ndër mend të thoshte gjermani. Kur u afrua komandanti, ata u shmangën pak mënjanë për t'i bërë rrugë. Pastaj u mblodhën përsëri.

— Si është puna?, — tha komandanti duke iu drejtuar oficerit gjerman.

— Me shumë rëndësi për ju, me shumë rëndësi për ju!, — u hodh spiuni, si në ethe, pa pritur që gjermani të fillonte të fliste.

Komandanti e pa një herë spiunin nga koka te këmbët dhe u kthye nga gjermani.

— Kishe gjë për të më thënë?...

— Sigurisht, — e ndërpreu spiuni, që s'duronte dot sa të fillonte gjermani, por padashur, me ndërprerjet e tij, e vononte atë më shumë.

— Në qoftë se doni, unë mund t'ju tregoj gjithë të fshehtat e instrumentit të torturës, — tha oficeri gjerman në gjuhën e vet.

— Në qoftë se doni, mund t'ju tregojë gjithë të fshehtat e instrumentit të torturës, — përktheu spiuni me një frymë.

— E pastaj?, — foli papritmas njëri nga partizanët aty përreth. Ai diç deshi të shtonte akoma, por një shok pranë tij ia bëri me shenjë të heshtte.

Oficeri gjerman ishte bërë pak nervoz nga pyetja.

Komandanti u mendua një copë herë në heshtje.

— Fol, fol, të dëgjoj, — tha ai pas pak me një nënqeshje thujtase të padukshme në fytyrë.

— Që të keni një ide sa më të plotë për instrumentin, — tha gjermani, — po filloj t'ju shpjegoj se si është prodhuar, pastaj si përdoret. Për fabrikin e mjeteve të torturës nuk ka firma të veçanta.

por me to merren firma apo truste produktesh paqësore, p.sh. truste automobilash, enësh kuzhine, tekstilësh. Cilat janë pikërisht këto firma dhe ku gjenden punishtet në fjalë është sekret, që as unë, as shumë njerëz më lart se unë nuk e dinë. Por mund t'ju them se instrumenti që keni përpara, është një nga asortimentet e shumta të ndryshme që prodhohen sot në seri në Gjermani dhe pastaj përhapen në tërë botën. DK-902, ky është numri i serisë së instrumentit që keni përpara, prodhohet sipas metodës zinxhir, apo metodës «Tejlor», e cila është marrë prej kohësh nga Shtetet e Bashkuara, me autorizimin e qeverisë përkatëse. Çdo çast pune është i llogaritur dhe i parashikuar në projektet e shumta që bëhen në zyrat e posaçme, dhe puna e projektuesit është shumë e vështirë, sepse, ndërsa si ushtar ai e konsideron atë si instrument torture, nga ana tjetër, si inxhinier, e konsideron atë si instrument precizioni. Kur t'ju shpjegoj funksionimin, do ta kuptoni më mirë pse duhet kaq precizion në një rast si ky. Kohët e fundit dëgjova se për prodhimin e DK-902-shit janë hapur mjaft degë edhe në vende të tjera të pushtuara nga ushtria jonë...

Oficeri, aq shumë e kishte humbur mendjen pas atyre që thoshte, sa kishte harruar se ndodhej te partizanët, se ishte rob i komunistëve shqiptarë dhe se po përpiquej t'i shpëtonte dënimit fatal, ose të paktën të shpëtonte instrumentin, duke i treguar komandantit të tyre të fshehtë e këtij instrumenti. Ai fliste sikur i duhej të demonstronte dijenitë e tij mbi instrumentin, apo sikur po hartonte ndonjë katalog, ndërsa komandanti që vrenjtur në fytyrë, vetullat e dendura gati sa nuk i takoheshin dhe ai mendohej, mendohej...

Robi sikur donte ta pyeste në e dëgjonte apo jo, ndërsa spiuni e shtynte lehtë me krah dhe i jepte shenjë, për t'i bërë të ditur se tjetri nuk po i kush-tonte sa duhej vëmendje ose, ndoshta, për t'i tër-hequr vërejtjen vetë oficerit gjerman, që ta ndry-shonte krejt mënyrën e të folurit.

— Fol, fol, — tha komandanti, që e vuri re shqetësimin e të dyve.

Grupit iu shtuan edhe dy-tre partizanë. Për një minutë a dy u dëgjuan pëshpëritje. Ata që sapo ki-shin ardhur, kërkonin të dinin se ç'bëhej, ndërsa të tjerët përpiqeshin kush e kush t'u jepte sa më shpejt sqarim.

— Për sa i takon shpërndarjes së veglave të torturës, — vazhdoi nazisti, — me të merren zyra që kanë inventarin e plotë të dhomave të torturës, që disponon Gestapoja e çdo qyteti të pushtuar. DK-902-shi si fillim u vu në përdorim vetëm në di-sa qytete kryesore të Gjermanisë, pastaj, me shtrir-jen e kufijve, u përhap në mjaft vende të tjera, si në Spanjë, Çekoslovakia, Poloni, Francë, Danimar-kë, Rusi, Greqi, Jugosllavi... — Oficeri u gëlltit një herë dhe shtoi: — Tani vijmë te funksionimi. Instrumenti DK-902 në funksionim nuk është aq i thjeshtë, sa duket në pamjen e tij. Përdoret për shpimin e gjoksit me anë të thyerjes ose të shtypjes së eshtrave të kraharrorit, por nuk është barbare, si torturat e mesjetës, përkundrazi, kjo është më te-për një ndërhyrje kirurgjike, në qoftë se mund të shprehem kështu. Instrumenti nuk përdoret as-njëherë pa praninë e mjekut ose të infermierit ush-tarak, sepse duhet gjetur me saktësi vendi, paksa mbi muskulin e diafragmës...

Komandanti dëgjonte i zhytur në mendime. Përpara syve i shfaqeshin skicat, projektet, programet, llogaritjet e gjata, gjithë ky aparat i madh e i ngatërruar, i shpikur prej disave, dëshira më e madhe e të cilëve ishte si e si të gjymtonin njerëzimin, dhe jo vetëm kaq. . .

Mbi ballin e komandantit dukeshin rudhat e dhembjes, përzier me ato të urrejtjes. Vështroi me radhë fytyrat e shokëve që ishin aty pranë. Sytë e të gjithëve qenë ngulur me urrejtje te nazisti. Ndërkohë ky i fundit kishte heshtur, ndërsa spiuni i thoshte diçka. Nga gjestet dhe pamja e shqetësuar e tij mund të kuptoje se ai ishte alarmuar nga mënyra se si kishte folur tjetri. Tani ai e luste me dëshpërim të bënte ndonjë gjë për të shpëtuar lëkurën, ndoshta po i thoshte edhe se nga ai varej gjithçka, se duhej të fillonin përsëri nga e para. . .

Komandanti vështroi edhe një herë me radhë fytyrat e shokëve që kishte pranë. Sytë e të gjithëve qenë ngulur te nazisti dhe spiuni. Ai e dinte se, të përmbaheshe në atë çast, ishte tepër e vështirë, se dora e ndonjërit mund të shkonte te arma dhe, me një breshëri të shkurtër, t'i shtrinte robërit të vdekur dhe se ai vetë, komandanti, nuk kishte arsye pse ta ndalonte.

— Në qoftë se doni, mund t'ju tregoj dhe mënyra të tjera të përdorimit, që mund t'ju duhen. . .

— Merrini, pushkatojini, — tha komandanti, duke mbledhur të gjitha forcat për t'u përmbajtur dhe u largua me ngadalë.

*
* *
*

Dy prej partizanëve e morën instrumentin mbi supe. Këmbëzat u rëndonin dhe i vrisnin sikur përpiqeshin pareshtur të futnin metastaza në trupin e tyre. Pas pak arritën pranë një gremine. Të gjithë partizanët u afruan në buzë të saj. Ata që e mbanin, e hodhën instrumentin, që, pas disa rrokullisjesh dhe goditjesh nëpër gurë dhe pasi ikset e tij u ngatërruan nëpër ferra, u përplas mbi një shkëmb dhe u thye.

ZHURMA E DAULLES

(Përrallë groteske me dy pjesë)

Njëherë, rreth njëqind vjet më parë, në fshatin NL-M-N ndodhi diçka që i tronditi të gjithë banorët e tij.

Pranë fshatit gjendet një përrua. Mbi përrua një urë e gurtë. Ajo është shumë e vjetër, aq sa nuk mbahet mend kur është ndërtuar. Ka një hark të madh dhe anash dy kamare. Në bregun tjetër, me truallin si të çjerrë nga ujërat, të mbuluar me kaçube dhe tek-tuk nga pemë të zhveshura, një mën-gjes u shfaq papritmas një kasolle. Forma e saj ishte me të vërtetë e çuditshme: ajo qe më tepër si një gungë dheu, pa dyer e pa dritare, vetëm me një hyrje të ulët, që gjithmonë ishte e zënë me një dërrasë. Po nuk qe forma e çuditshme e kasolles që sillte tërë atë shqetësim. Sigurisht, edhe ajo kishte të bënte për disa, të cilët nuk u tronditën nga ngjarja në vetvete, sesa nga fakti që një gjë e tillë nuk ishte parë kurrë. Ndërsa më të shumtët e kishin hallin gjetiu: që brenda kasolles vinte një zhurmë e pandërprerë dauulleje. Ajo vazhdonte ditë e natë, me të njëjtin ritëm, dhe kushdo që kalonte mbi urë, duhej të hidhej sipas ritmit të saj. Për të mbikëqyrur

këtë, në skaj të urës rrinte një grup njerëzish të armatosur, të cilët asnjëri në fshat nuk i njihte, nuk dihej si kishin dalë e nga kishin dalë.

Ura ishte për banorët vendës rruga kryesore për t'u lidhur me krahinat përreth. Mbi të kalonin çdo ditë gati gjysma e fshatit. Mirëpo tani duhej të kaloje duke kërcyer sipas ritmit të daulles, dhe askush prej tyre nuk mund ta duronte këtë turp.

Çdo bashkësi njerëzish, ashtu siç ka koka të shquara, ka edhe të çmendurit e vet, edhe sarhoshët, edhe të shtururit pa karakter, por edhe këta të fundit bëhen nganjëherë të nevojshëm. Pothuaj se kështu ndodhi në rastin e urës: një djalë i ri, me fytyrë të rrudhosur para kohe, i cili njihej nga të gjithë si i paudhë, ndaj dhe e përçmonin, kaloi mbi urë duke u hedhur e përdredhur, duke marrë poza shumë komike. Në atë kohë ndodhi diçka që nuk pritej: daullja ndryshoi menjëherë ritmin dhe bashkë me të ndryshoi kërcimin edhe ai që kalonte mbi urë. Tërë kjo e bëri akoma më komike pamjen e tij. Fshatarët që prisnin në breg, në fillim u shqyen gazit, por pak nga pak mbi fytyrat e tyre zuri të binte një perde zymtësie, ngaqë, si duket, përfytyronin veten në gjendjen e lolos.

Një pjesë e madhe filluan të shpresonin se daullja, përderisa e kishte ndryshuar ritmin, edhe mund të pushonte fare. Kështu arsyetonin ata. Pritën një ditë, pritën dy. Ajo vazhdonte ditë e natë pandërprerë. Atëherë vendosën të gjenin mënyra të tjera: njëri u përpoq të kalonte me not, një tjetër ta kapërcente përroin aty ku vendi dukej më i ngushtë, madje disa provuan të ndërtonin një tjetër urë. Por të tëra përpjekjet shkuan kot.

Më në fund, të gjithë u shtrënguan të kalonin

mbi urë. Ata u vunë në rresht njëri pas tjetrit, kauluan urën duke u tundur sipas ritmit të daulles, që herë pas here ndryshonte, si në rastin kur kaloi loloja; kështu dukeshin si disa kukulla të trishtuara, fytyrëvrara, lidhur nëpërmjet penjsh nga duar të padukshme, të cilat i lëviznin sipas qejfit. Aty u vure diçka tjetër, një veti fort e çuditshme e daulles: zhurma e saj, në mënyrë krejt të pakuptueshme të detyronte të kërceje, pavarësisht në doje apo s'doje, dhe lëvizjet bëheshin fare jashtë kontrollit tënd. Deri atëherë fshatarët kishin pandehur se për të kërcyer ishin rojet ata që i shtrëngonin, por u kuptua që ata ishin, si duket, vetëm për të ruajtur kasollen në formë gunge.

Kjo vazhdoi për një kohë të gjatë. Njerëzit çdo ditë kalonin urën duke kërcyer, ktheheshin duke kërcyer, ndërsa kokëmëdhenjtë e armatosur qëndronin e bënin roje. Megjithatë njerëzit nuk u mësuan me kërcimin sipas ritmit të daulles, dhe tani u dukeshin një gjë po aq qesharake, sa ditën e parë.

Por në atë kohë doli fjala se gjithçka, edhe rënia e pandërprerë e daulles, edhe kasollja në formë gunge prej dheu, edhe kokëmëdhenjtë trupshkurtër që askush nuk i njihte dhe që dukeshin si qenie të ardhura nga bota e përrallave, pra gjithçka ishte sajuar nga agai, zot i vendit. Kjo hamendje u përforcua kur një ditë, ai, bashkë me disa gra, dolën në një ballkon të pallatit të tij, dhe prej andej, duke qeshur me të madhe, shikonin fshatarët që shkonin mbi urë. Që atëherë ai nisi të dilte vazhdimisht në ballkon dhe priste orën kur do të kalonin fshatarët.

Banorët e fshatit NL-M-N kishin dëgjuar shpesh për pengesat që nxirrnin feudalët, bejlerët, pashallarët, banorët në lidhje me taksat e rrugës. Këto

pengesa arrinin deri në plotësime tekash. Mirëpo si kjo që po u ndodhte vetë atyre, nuk kishin dëgjuar asnjëherë. Të gjithë u përpoqën të gjenin shkakun pse ua kishte bërë këtë agai zot i vendit. U dhanë mendime nga më të ndryshmet. Disa thoshin se e bënte për t'u argëtuar, vetëm e vetëm për të kënaqur trillet e tij, të tjerë thoshin se qe një rrugë nënshtrimi; këtë e lidhnin me faktin se kohët e fundit taksat e të dhjetave ishin rritur. Disa të tjerë, të lidhur me bestytini, thoshin se në shtëpi të tij kishite rënë një sëmundje, për shërimin e së cilës ishte i domosdoshëm ky ritual. Kishte dhe nga ata që thoshin se për këtë nuk kishte ndonjë shkak, as argëtim e kënaqje trillesh, as shërim sëmundjesh, por agai e bënte këtë ashtu kot, kot fare. Ndonjëri arrinte deri atje sa të mendonte se shkakun i së keqes së përbashkët mund të qe ai vetë, për ndonjë sherr që kishte pasur përpara me aganë, zotin e vendit, ose, edhe pa pasur asnjë lloj ngatërrese, por vetëm prej ndonjë sjelljeje që atij mund të mos i kishte pëlqyer. Ndonjë tjetër, që mendonte po kështu, ua fshihte shokëve ngjarjen që mund ta kishte futur fshatin në tërë atë ngatërresë.

Ndonëse u shprehën hamendje nga më të ndryshmet, të gjithë e pranonin se kështu nuk mund të vazhdohej më.

2.

Në fshatin NL-M-N jetonte një familje lëkurëpunuesish. Ata kishin disa kohë që po bënë një daulle shumë të madhe (ndoshta mund të mos qe daulle, mund të qe vetëm një copë e madhe lëkure,

që do të përdorej për kushedi çfarë, por sidoqoftë, dikujt që e pa, i ra ndër mend se me të mund të bënin një daulle të madhe, aq të madhe, sa të mbys- te zhurmën e asaj tjetrës tek ura).

Mbas disa ditësh lëkurëpunuesit arritën ta mba- ronin. E morën daullen, e çuan tek ura dhe e ulën përtokë; përmasat e saj ishin të tilla, sa lejonin t'i binin deri në tre-katër vetë. Të gjithë qenë mble- dhur përreth. Sytë e tyre qenë ngulur plot shpresë, në pritje të asaj që do të ndodhte; nuk e dinin ta- mam se çfarë, po prapë parandienin diçka. Daullja tjetër binte pareshtur. Rojtarët e panjohur shihnin si të habitur, me sy të zgurdulluar jashtë mase, thujse zhurma gjëmonte edhe brenda kokave të tyre. Në atë kohë nga bregu matanë u dëgjua daull- ja e madhe, një bubullimë shurdhuese, një bum- burubum — dumdurudum e çrregullt, tmerruese, pa kurrfarë ritmi. Gjashtë vetë (lëkurëpunuesi, bijtë e tij, bashkë me disa të tjerë) kishin rrëmbyer ca shkopinj të trashë, me të cilët po i binin daulles me gjithë fuqinë. Nga kasollja-gungë prej dheu nuk ndi- hej më asgjë. Atëherë banorët e vendit filluan të kalonin mbi urë, duke ecur tamam, jo duke kërcyer. Rojet kokëmëdhenj nuk lëviznin fare, ata shtangën në vend.

Kështu vazhdoi tërë ditën: njerëzit kalonin urën, njëlloj si më parë, kur nuk kishte pasur fare daulle. Por ndaj të ngrysur rojet u shkulën prej ve- ndit të tyre, kaluan në bregun tjetër dhe u hodhën mbi daullen, të pushtuar nga një ekstazë shkatërri- mi. Gjithashtu, një turmë fshatarësh u sulën mbi kasollen, duke dashur ta shembin, pastaj, si e rrë- zuan, nisën të shqyenin daullen tjetër. U bë një rrë- mujë e paparë, zhurma, britma, zjarre, hije dhe, si

dimisht. Në përfytyrimin e tij akrepat e orës i qenë shfaqur si nofullat e këtij përbindëshi, që hapeshin e mbylleshin duke përtypur kohën, duke e copëzuar atë në orë, minuta, sekonda. Ky lloj copëzimi i dukej gjithnjë disi i pakapshëm. Në fshatin e tij, ku asnjëri nuk kishte orë, ai që mësuar ta perceptonte rrjedhën e kohës në mënyrë më konkrete, më të prekshme; për të ky fenomen gati-gati sendëzohej në dendësinë e ngjarjeve dhe të veprimeve.

Mbasi përshkoi sheshin e qendrës së qytetit, ai u kthye në një rrugë të ngushtë, që ndahej në dy pjesë krejt të pangjashme, si të ngjitura gabimisht me njëra-tjetrën. Në krye të saj, nga të dyja anët, vinin ndërtesa dykatëshe, aty-këtu me zbukurime rrethore e të lakuara, të stilit venecian, që përmes territ të krijonin imazhin e turbullt të një faune nënujore. Më tutje, në një pikë, vargu i këtyre ndërtesave këputej papandehur, rruga kryqëzohej me një rrugë tjetër, pastaj fillonin menjëherë shtëpi me oborre, rrethuar me murana të larta. Kjo pjesë e rrugës ishte e pashtuar dhe me gjurmë rrotash e zinxhirësh. Në njërin anë të saj, në një kanal, që përmbysur një triçikël, si qenie gjysmëuloke. Këtej kanë ikur dje, tha ai me vete, duke vështruar herë gjurmët, herë triçiklin.

Ai u kthye në një rrugë tjetër. Tabela me emrin e rrugës kishte rënë përtokë e deformuar, e ngjashme me një shqyt apo parzmore të vjetër, mbetur nga një kohë tepër e largët. Ai mendoi kalimthi se kështu kishte parë gjatë asaj dite plot tabela me emrat e rrugëve. Dita e parë e Çlirimit, shtoi me vete. Si eci rreth njëzet metra, ndaloi para një porte të madhe të drunjte. Mbi të ishin mbërthyer dy iniciale prej hekuri, M.K. Shtyu por-

tën dhe u fut në një kopsht të gjerë. Gjithandej kishte shtrete lulësh, më tepër me kërcëj trëndafilash, për të cilët, siç dukej, nuk qe kujdesur njeri prej disa kohësh; megjithatë shtretet e luleve vazhdonin të ruanin një farë rregullsie të veçantë. Aty-këtu midis tyre kishte pemë të zhveshura me degë të holla. Muret e oborrit qenë mbuluar krejt me bimë kacavjerrëse, me fletë në formë gjuhësh të vogla të panumërta. Ai eci përmes kopshtit në një shteg të mbuluar me gurë. Pak më tutje mund të dalloheshin konturet e gurta të një ndërtese, me dritaret ku dukej drita e kuqërremtë e zjarreve, që me luhatjen e saj krijonte çdo çast në katrorët e xhamtë miniatura agullimi dhe muzgu. Shtegu i gurtë pak nga pak zgjerohej dhe mbaronte përpara ndërtesës në një shesh të rrumbullakët. Aty kishte copa kolonash me kapitete jonike, një pus dhe një shatërvan të bardhë me një statujë nudo. Shtëpia ishte dykatëshe, gjithashtu e bardhë, ndërtuar pa shije. Ajo për afrohej deri-diku me një kuti të stërmadhe. Ajo ishte vërtet e gjerë, aq sa mund të nxinte lirisht kompaninë partizane, që ishte strehuar aty atë natë. Kur kaloi te shatërvani, ai u skuq lehtë dhe ktheu kokën në anën tjetër.

Salloni i katit të parë, që vinte menjëherë pas hyrjes, qe mbushur plot me partizanë. Vetëm pak prej tyre flinin, pjesa më e madhe bisedonin ose merreshin me ndonjë gjë. Kudo përreth mund të shihje kapota dhe batanije gri, të murme, të gjelbra. Disa i kishin hedhur supeve ose mbi gjunjë, disa i kishin shtruar poshtë, disa i kishin lënë anash, për të vënë mbi to armën, trastën apo ndonjë send tjetër. Aty pranë një partizan po shkruante në një copë letër të mbështetur në një çantë meshini; iu

kujtua se duhej të takonte korrierin. Bëri disa hapa dhe u afrua te një partizan me flokë të ashpër ngjyrë gështenje, pastaj e preku lehtë në krah. Tjetri u kthye përgjysmë.

— Ç'ke, Asim?, — e pyeti me zë të ulët.

— E ke parë Vlashin?

Ai u kthye i tëri dhe e vështroi me dy sytë e vegjël, pastaj rrudhi ballin një çast, sikur përpiquej të sillte ndër mend diçka.

— Deri tani këtu ishte... sapo iku. Hajde kërkkoje pas ndonjë ore, më mirë.

Qëndroi një hop pa lëvizur, pastaj përshkoi krejt sallonin, përmes partizanëve që rrinin ulur ose shtrirë përgjysmë, në pozicione të ndryshme. Shkallët që çonin në katin e dytë kishin parmakë të mermertë; edhe nëpër shkallë qenë ulur partizanë. Salloni i katit të dytë gjithashtu nuk kishte asnjë mobilje. Ishte më i ngushtë se salloni i poshtëm dhe pak më i gjerë se një korridor, por komunikonte me dyer të shumta. Anash kishte dy korridore të vogla, gjysmë të errëta. Nën hapat e tij dyshemeja bënte një zhurmë monotone.

Ai hyri në një dhomë katrore me dritare nga ana e prapme e shtëpisë. Zjarri i ndezur në oxhak ndriçonte tërë hapësirën e dhomës.

— Vdekje fashizmit, — tha Asimi, pa lëvizur akoma nga ambrazura e derës.

— Liri popullit.

Aty qenë gjashtë partizanë, bashkë me një djallë të ri me kostum dopiopet, një anëtar i Qarkorit nga qyteti. Ata rrinin ulur mbi dërrasat e gjata të dyshemesë duke mbështetur shpinat në mur. Disa armë qenë varur në dorezat metalike të dritareve. Ndërsa vazhdonte biseda, për një çast e këputur,

Asimi hoqi pushkën dhe kapotën gjermane dhe zuri vend pranë anëtarit të Qarkorit. Në krahun tjetër që ulur Miti, me dorën e majtë ende të pashëruar, përballë kishte infermierin e kompanisë dhe Barton, një djalë nga fshatrat e Kurveleshit, me mustaqe të rralla, në ngjyrë pak më të çelur se flokët. Ai e ndërpriste herë pas here me një të qeshur të mbytur, me nofulla pak të shtrënguara, pastaj bëhej përsëri i vrenjtur. Miti u afrua te zjarri dhe me dorën e tij të shëndoshë rregulloi drutë njëfarësoj.

— E, si t'u duk shtëpia?, — tha në këtë kohë Dalan Shkurti, zëvendëskomisari i kompanisë, një burrë rreth të tridhjetave, trupngjeshur, me një xhoke fanellate ngjyrë ulliri. Asimi heshti pak, por pas një çasti ktheu kokën dhe e mori vesh se Dalani i drejtohej atij.

— Vërtet, e kujt do të ketë qenë kjo shtëpi?, — pyeti ai, duke u kthyer paksa nga anëtari i Qarkorit.

— Pse, nuk e takove të zotin?, — ndërhyri papritur Miti, me një nënqeshje gati të padukshme. Ai kishte një fytyrë eshtake në formë trekëndëshi, gati si maskë. — Nuk ma ha mendja mos të të ketë pritur te porta e madhe, pastaj të ka shëtitur në oborr dhe të ka treguar trëndafilat, bahçen,... a nuk të gostiti me çaj në sallonin me kolltukë të bukur?...

Asimi ngeli një çast, mendoi se i zoti ishte aty dhe, me sa dukej, partizanët diku e kishin mbyllur. Por shpejt e kuptoi. Ëhë, ia bëri dhe tundi kokën. Të tjerët qeshën pak; ata qenë mësuar me trillet e herëpashershme të Mitit.

— Ai kishte veshur një rrobë të zezë, — vazhdoi Miti. — kishte dekorata e stema nga mbretër të

Nënkapitull: Idhuj në erë

Dy ditë më parë, në mbasdreken e 27 Nëntorit 1944, një turmë e madhe njerëzish me valixhe, me çanta, ca me kostume udhëtimi, ca me veshje zyrtare, ngaqë nuk kishin pasur kohë të përgatiteshin për udhëtim, prisnin te bankina e vjetër në breg të lumit, pranë qytetit. Turma përbëhej nga deputetë, legalistë, ballistë, ca spiunë dhe ndonjë i vetëquajtur social-demokrat. Aty u gjend një anije e vogël. Ajo nuk mund t'i nxinte të gjithë, prandaj ata filluan të grindeshin, të shtyheshin, të shaheshin. U përleshën keq me njëri-tjetrin, madje disa u rrahën mes tyre. Edhe gratë ziheshin, duke lëshuar klithma të shkurtra, të mprehta. Njëra i tërhiqte mantelin apo flokët asaj që kishte përpara, një tjetër i gërvishte krahun me nervozizëm asaj që kishte anash dhe që e shtynte me bërryla në bark, një tjetër kërkonte mbrojtjen e burrit, i cili kërkonte drejtësi dhe fyente një zotni që i shtypte gjishtin e këmbës me fundin e bastunit. Më në fund, mbas përpjekjesh të shumta, vetëm një pjesë arriti të hipte, duke zënë vend ngushtë e ngushtë, duke u shtypur, ndërsa të tjerët që mbetën në bankinë, si dhe nja dy më fatkeqët, që gjatë përleshjes kishin rënë në ujë, shoqëronin me sy të trishtuar anijen që ikte, duke lënë aty vetëm shtëllunga të holla, të bardha.

Po atë mbasdreke, në një plazh të zbrazët rreth 50 km në jug të qytetit, një deputet bashkë me katër të tjerë prisnin t'i merrte një motoskafe i anglezëve. Katër të tjerët ishin: sekretari i tij, një avokat, një ish-këshilltar bashkie i qeverisë mbretërore dhe një ish-gjerark, i atashuar pranë misionit diplomatik të Vatikanit. Ata kishin pritur tërë parad-

ten dhe disa orë të mbasdites, por motoskafi s'ishte dukur. Më në fund, si i humbën shpresat, duke mos ditur ç'të bënin, ecën e ecën, plot një orë, përgjatë bregut. Ishte një mbasdite gri. Deti përplaste me plogështi në breg copëra dërrasash, guaska, skeletin, e ndonjë peshku të ngordhur, shishe të zbrazura, të thyera. Dielli, me një ndriçim të mekët, dukej si një gjurmë në sfondin e përhirët, një gjurmë e rrumbullakët, e lëvizshme. Mbasia ecën plot një orë, ata gjetën një varkë druri me dy rrema. E shtynë varkën në ujë dhe hipën në të. Por nuk kaloi shumë dhe nisi një erë e fortë, filluan dallgët, varka shkante sa andej-këtej nëpër det, në drejtim të pacaktuar, herë në një anë, herë në tjetrën, duke u rrotulluar rreth vetes. Ata u munduan për një kohë të kundërshtonin dallgët dhe erën, por asnjëri nuk dinte ta ngiste varkën dhe kështu humbën edhe rremat. Tre prej tyre i zuri deti. Pa gjumë, të lodhur e të qullur krejt, ata u shtrinë mbi dërrasat e varkës, ku uji ishte futur dy-tre gisht, duke u përzier me të vjellat, dhe qëndruan ashtu një kohë të gjatë, ndoshta pesë orë, ndoshta më shumë, ndoshta ditë të tëra, nuk dihet sa. Por aty nga fundi i një mbasditeje dallgët u ulën dhe ata e morën veten disi. Mblodhën forcat dhe u çuan, duke u përpjekur të ruanin ekuilibrin. Vunë ré se toka kishte humbur. Era e lehtë e shtynte varkën në një drejtim, që ata nuk qenë në gjendje ta përcaktonin. Gjendeshin larg vendnisjes. Barka tani kishte arritur paksa në jug të ngushticës së Otrantos, por ata shihnin përreth vetëm masën e pafund të ujit, me një shkëlqim të lehtë alumini, një botë anonime, pa koordinata. U dukej sikur gjendeshin në një planet të braktisur. Po errej me shpejtësi. Humbëm, thanë ata. Por, më

në fund, në horizont u nder, si një buzëqeshje, një vijë tymi. Ajo u afrua, u afrua dhe, pa u errur mirë, pranë tyre kaloi një vapor panamez. Ishte një vapor i zi, i madh. U afrua pranë tyre dhe i mori.

Vazhdim i kapitullit të parë

— Sa do të jetë ora? — pyeti një partizan flokëkuq, i cili deri atëherë kishte qëndruar në heshtje.

Dalani nxori nga xhepi një orë të rumbullakët, me fushë të bardhë. Shigjetat tregonin njëmbëdhjetë e njëzet. Infermieri rrinte i kthyer pak anash, i mbështetur në njërin bërryl dhe po merrej me disa letra të vogla. Ai përpiqej t'i lexonte copat e letrës, i kthente në drejtim të dritës, i afronte te sytë, i largonte. E bënte këtë disa herë duke përsëritur afërsisht të njëjtat lëvizje, pastaj i paloste dhe i linte aty pranë të renditura me kujdes njëra mbi tjetrën.

— Çfarë i ke ato?, — u bë kureshtar Asimi.

— Listat e ilaçeve që na duhen. Nesër do vete në spitalin e qytetit t'i marr.

Anëtari i Qarkorit vazhdoi të tregonte me zë të ulët, duke shqiptuar fjalët pothuajse me cepat e buzëve.

-- Mbrëmë natën na ndodhi në qytet diçka e papritur, — tha ai dhe u gëlltit prapë. — Gjithë njerëzit ishin futur nëpër shtëpi dhe gjithçka kishte rënë në qetësi. Kur befas, në një rrugë andej nga periferia, u dëgjua një zhurmë motoçiklete dhe mandej breshëri të gjata mitralozi. Zhurma afrohej, kalonte nga rruga në rrugë, nga lagjja në lagje dhe kudo dëgjoheshin breshëritë... Gjermanët atë ditë

kishin bërë evakuimin, të tërë i kishin parë duke u larguar mbi udhën veriore, por tani që dëgjonin mitralozin pandehën për një çast se mund të ishin kthyer, ose kushedi, një pjesë e tyre paskëshin mbetur që më parë në qytet dhe tani endeshin gjithandej me triçikla. Ndërkohë plumbat binin pa pushim dritareve dhe bënin copë-copë xhamat... Pak më vonë ne pikasëm se ishte vetëm një triçikël, me dy ushtarë gjermanë, njëri në timon, tjetri në kosh, te mitralozi; fishekët e tyre s'kishin të mbaruar dhe ata kishin për të vazhduar tërë natën...

— Po pastaj, ç'u bë me ta?, — pyeti Batoja, që dukej i paduruar dhe më i vrenjtur se zakonisht.

— Pastaj u ndeshën me një njësit partizan dhe u asgjësuan.

Në kujtesën e Asimit u përftua qartë dhe ngeli pezull për disa çaste figura e triçiklit të përmbysur që kishte parë atë natë duke ardhur.

KAPITULLI I DYTË

Përjashta nisi të frynte pak erë. Ajo tundte lehtë degët e pemëve dhe kalonte me një si rrëshqitje të nxitimtë nëpër gjuhët e bimëve kacavjerrëse.

— Pse nuk fle?, — i tha anëtari i Qarkorit Asimit.

— Nuk më vjen gjumë, — tha Asimi. — Mbase pak më vonë...

Ndonëse ishte disi i lodhur, ai nuk donte të flinte. Një natë më parë e kishte gdhirë dhe tani poshtë syve i qenë formuar hije ngjyrë gri. Sytë i digjnin një çikë, por ai kishte vendosur të flinte më vonë, në qoftë se do t'i merrte gjumi dhe të tjerët.

Asimi ktheu kokën nga e majta; mund të shikonte për një çast profilin e brishtë të anëtarit të Qarkorit, flokët e tij të krehur e të ndarë me kujdes. Mbas tij dukej guna prej shajaku të hirtë e Batos, varur pranë derës, me kapuçin e saj të gjerë dhe me fundin e hapur në të dyja anët. Guna i përngjante kështu figurës së ndonjë zogu gjigant.

Asimi ktheu prapë kokën. Përballë kishte Dalanin, që fliste me Baton me zë të ulët. Miti rregullonte fashon e dorës së plagosur, infermieri kishte mbaruar punë me copat e letrës dhe po dridhte një

cigare. Siluetat e tyre projekttoheshin në mur të zmadhuara dhe të shpërpjesëtuara në mënyrë pak të çuditshme, me supe të mprehta e koka të zgjatura, gati me majë. Luhatja e flakëve bënte që siluetat të vallëzonin mbi mur.

I erdhi në mendje që duhej të kërkonte korrierin e kompanisë. U ngrit, hapi derën, pastaj e mbylli prapa vetes me ngadalë. Përsëri zhurma monotone, e zvergur e dyshemesë nën hapat e tij. Kaloi nëpër dhoma, që vinin njëra pas tjetrës, ku rrinin partizanë. Disa qenë të mëdha, disa të ngushta, po të tëra të zbrazura nga mobiljet. Megjithatë ndryshonin çuditërisht shumë nga njëra-tjetra. Ndysimi niste që nga dritaret, nga forma e pezulit dhe e kornizave, nga vizatimet dhe skalitjet anash. Muret dhe tavanet kishin një dekor të ngarkuar me gjithfarë stilesh: venecian, oriental, malazet, francez, rus. Dukej sikur kapërceje treva shtetesh, gadishujsh, kontinente... Ndonëse ndodhte brenda disa minutash, e gjithë kjo dukej si një udhëtim nga shekulli në shekull. Asimi kaloi nëpër shumë dhoma; hije-drita regëtitëse e zjarreve u jepte dekoreve një pamje të panatyrshme, disi të largët, duke u përthyer mijëra copash në gdhendjet e imta me ngjyra.

Nënkapitull: Hartografi e pjeshme e kohës

Shtëpia që ndërtuar më 1931, me pasurinë që kishte grumbulluar i zoti i saj. Ai nuk kishte pasuri të patundshme, prona tokash apo punishte dhe shumë njerëz u habitën në fillim se si arriti ai të ngrinte një shtëpi të tillë. Nga prindërit që kishin vdekur kur ai ishte në një moshë fare të re, duke e lënë

vetëm, ngaqë nuk kishte as motra, as vëllezër, ai pati trashëguar vetëm një dyqan jo fort të madh, që e shiti menjëherë...

Tërë jetën e kaloi duke bredhur nëpër botë, duke bërë aventura fantastike, duke u ngatërruar gjithandej nëpër ambientet politike, letrare, mon-dane, duke u futur në të gjitha sallonet e kohës. Sipas mënyrave të tij, si një aksident i rastësishëm, ai arrinte të ngatërrohej në shumë ngjarje të më-dha e të zhurmshme...

Ai ikte nga qyteti përherë natën, tinëz, dhe ve-tëm të nesërmen ose disa ditë më vonë vihej ré se mungonte. Kthimi i tij ishte përherë me bujë, shu-më njerëz dilnin nëpër dritare e nëpër rrugë që ta shihnin, pastaj nisnin vizitat, që zgjatnin për disa ditë rresht, nga të gjithë të njohurit, dhe ai u tre-gonte historitë e atij udhëtimit...

Dalja e parë ngjau aty nga fillimi i dekadës së dytë të shekullit, siç thonë, në Kroaci dhe në Itali. Për këtë ai përdori paratë që sapo kishte marrë nga shitja e dyqanit...

Pastaj dalja e dytë, e tretë...

Kur kthehej, sillte me vete gjithmonë diçka si trofé, shpesh trofé të kushtueshme, komplete mo-biljesh apo shandanë të mëdhenj të argjendtë, gjith-monë të vjedhura me mënyra tepër origjinale, në pragun e së pabesueshmes. Bashkë me të tjerat, sa herë vinte, sillte edhe dy-tri rrënjë trëndafilash të llojeve të ndryshme. Kështu, me kalimin e viteve, ai arriti të koleksiononte pothuajse tërë varietetet e trëndafilave, nga Spanja deri në Suedi..

Dalja e katërt, më 1915, e çoi në Rusi. Dalja e pestë, më 1917, prapë në Rusi, pak para Revolu-cionit. Aty e kapi edhe Lufta Civile. Udhëtoi nga

Deti i Zi deri në Irkutsk. Diku në Siberi, në një nga linjat hekurudhore transuraliane, ai vodhi një sasi parash të Kollçakut. U kthye nëpër pështjellimin e vijave të frontit dhe në kufirin polak apo austro-hungarez vodhi nga një vagon një sasi tjetër parash, këtë radhë të Bela Kunit. Kështu, në daljen e pestë ai kreu dy vjedhje në skajet e një distance prej mijëra kilometrash: mids këtyre dy vjedhjeve shtrihej hapësira e paanë e Euroazisë...

Paasurinë e fituar në këtë mënyrë ai nuk e depozitonte, por e shpenzonte thuajse tërësisht për udhëtime të reja, ku në më të shumtën e herëve këto shpenzime i kompensonte rishtas. Po një herë ndodhi që ishin ditët e fundit para kthimit dhe ai nuk kishte marrë asgjë. Mendoi se duhej të kthehej në qytet patjetër me diçka, të paktën me një trofë simbolike dhe kështu përvetësoi një tablo origjinale të Rembrandtit...

Në daljen e tetë, të nëntë apo të njëmbëdhjetë, kjo nuk mbahet mend tamam, sepse në këtë periudhë numri i daljeve fillon e ngatërrohet, ai shkoi në Francë dhe aty mori pjesë në Internacionalen trockiste. Por nuk mund të mendohej se ai njeri mund të angazhohej në të, apo qoftë në ndonjë parti apo lëvizje tjetër, duke u nisur nga motive thjesht politike. Edhe disa herë të tjera më parë, kur kishte qenë në vende të ndryshme, ai kishte bërë pjesë për një farë kohe në ndonjë parti ose në ndonjë grup komplotistësh politikë, por kjo gjë i kishte shërbyer vetëm për aq, sa kishte qëndruar në aksh vend, për të krijuar aty një farë reputacioni. Kështu veprimi edhe kësaj radhe dhe, para se të largohej nga Franca, shpalli dorëheqjen...

Njëherë thuhet se është takuar me Skënder de

Vidin, të birin e Princ Vidit, kjo në daljen e tij të fundit. Mbas kësaj ai nuk doli më në Evropë, sepse pati një paralizë që e shtrëngoi të rrinte brenda në shtëpi, mbi një karrige me rrota, nën përkujdesjet e një mbese. Ai fliste gjithmonë e më tepër për trashëgimtarin e fronit; çdo njeriu që i vinte për vizitë i tregonte për aventurat e tij të fundit, i tregonte për princin austriak apo gjerman me emrin Skënder, të birin e monarkut që kishte sunduar vetëm tetë muaj në Shqipëri, duke e quajtur veten hera-herës oborrtar dhe kalorës të princit...

Iku Ahmet Zogu, erdhën italianët, gjermanët e ai vazhdonte të fliste për Princ Vidin. Madje, edhe kur u pa se gjermanët së shpejti do ta kishin të humbur, ai fliste gjithmonë për Princ Vidin. Derisa një ditë iu pre goja dhe ai komunikonte vetëm me sy. Sytë e tij të shpëlarë, të turbullt, u bënë atëherë çuditërisht shprehës, në mundimin e tyre për të zëvendësuar gojën. Më në fund, afro tri javë para çlirimit të qytetit, vdiq në dhomën e tij mbi karrigen me rrota...

Testamenti i tij la të mahnitur shumë njerëz në qytet. Ky testament që hartuar rreth pesëmbëdhjetë — sipas thënies së të tjerëve rreth njëzet vjet më parë — dhe bënte fjalë për një pendesë të madhe të të ndjerit në lidhje me gjithë ç'kishte bërë deri atëherë në jetë dhe, siç dihet, vazhdoi të bënte edhe pasi kishte shkruar testamentin...

Vazhdim i kapitullit të dytë

— Në këtë qytet kanë kaluar shumë pushtues të ndryshëm, — po thoshte anëtari i Qarkorit, duke

vështruar ngultas përballë tij, — perandori, mbretëri, principata, despotate, republika... Në fillim erdhën romakët, pastaj gotët, bizantinët, kryqtarët, sllavët, serbët, venedikasit, turqit, malazezët, austriakët, italianët, gjermanët... Romakët kanë ardhur në vitin 168 para Erës sonë...

Asimi kishte zënë vend përsëri midis Mitit dhe anëtarit të Qarkorit. Ai rrinte mbi dysHEME, duke u mbështetur në bërrylin e majtë. Tani në dhomë ishte dhe një partizan tjetër, i cili që ulur pranë zjarrit dhe përgjithësisht rrinte në heshtje, vetëm rrallë thoshte diçka. Dalani, që vitet e fundit kishte nisur të interesohej për historinë, dëgjonte me vëmendje ato që thoshte anëtari i Qarkorit. Po ashtu bënin dhe të tjerët. Hektori dëgjonte i përhumbur në mendime.

— Aty nga shekujt e parë të Erës sonë kanë qenë visigotët, ostrogotët dhe hunët... disa thonë se pikërisht një nga këto tri fise, nuk dihet saktë se cili, e ka djegur disa herë pjesë-pjesë qytetin...

— Me sa di unë, gjatë kësaj periudhe u bë ndarja më dysh e Perandorisë së Romës, — tha Dalani.

— Po, — ia bëri anëtari i Qarkorit, — dhe ne u përfshimë në pjesën lindore... Më vonë erdhën dy herë sllavët...

Të shkatërrosh një urë, tha me vete Hektori. Ato ditë ai kishte parë dhjetëra ura ose më tepër të hedhura në erë. Iu ravijëzuan ngadalë dhe qartë në përfytyrim bazamentet e prishura, mbeturinat prej betoni dhe çimentoje që binin në ujë, derisa pak nga pak zhdukej aty gjithçka, humbiste në masën e turbullt që lëvizte pa pushim, ndërsa përtej ishte bregu tjetër, befas në një largësi tronditëse.

Të gjithë invazorët, kur ikin të mundur, shkatërronjë urat, tha përsëri me vete. Papritur i qe kujtuar legjenda e vjetër e murosjes në urë. Pushtuesit bënë të kundërtën, vendosnin antinjerëz të trupëzuar në formën e minës, që të shkatërronin urat. Partizanët qëllonin vazhdimisht që të mos i linin ato të minoheshin. Trupat e ushtarëve gjermanë rrëzoheshin mbi njëri-tjetrin, helmetat rrokulliseshin mbi asfalt. Nga skaji tjetër i urës vinin pareshtur ushtarë të tjerë gjermanë dhe binin aty të shqyer nga plumbat, si në një përpjekje të fundit, që me pirgjet e kufomave të tyre të bllokonin kalimin e urës.

— Ka edhe një thënie tjetër të pavërtetuar mbi kalimin e Kryqëzatës së Parë dhe të ushtrisë normane, — vazhdoi anëtari i Qarkorit. — Në kalimin e këtyre të fundit bazohet hamendja se qyteti nuk ka qenë djegur në nisjen e Erës së re por më vonë...

Ndërkohë infermieri, i cili pak më parë kishte dalë, u kthye përsëri. Partizani që kishte ardhur më vonë në dhomë dhe që rrinte pranë zjarrit, një djalë fare i ri, me mollëzat e faqeve pak të dala, u ngrit dhe u afrua tek infermieri.

— Më ngarkuan të lajmëroj se spitali do të hapet që herët në mëngjes, — i tha atij, — Është një masë që mori komanda e Brigadave... Qysh nesër do të rifillojë funksionimi i shumë dyqaneve dhe punishteve, i furrave të mbyllura prej disa kohësh, — shtoi pas pak me një buzëqeshje të shkurtër, duke u drejtuar nga të tjerët.

Miti shkoi te zjarri.

— Të dhemb dora?, — pyeti Batoja.

— Dora? Jo, — tha Miti, pasi ktheu nga ai fytyrën dhe e vështroi një hop.

Dalani vazhdonte diskutimin me anëtarin e Qarkorit.

— Këtë të normanëve nuk e dija, — tha i menduar dhe pas një çasti shtoi: — Ti e njeh vërtetë mirë historinë... Si i ke mësuar gjithë këto!?

Në ballin e pjerrët të anëtarit të Qarkorit, aty ku vetullat takohen me hundën, formoheshin tri rrudha vertikale.

— Kur mbaronim mbledhjen, rrinim akoma dhe këndonim këngë revolucionare, ose flisnim për komunizmin. Ato që dinim nga «Anti Dyring», p.sh., mbi marrëdhëniet në prodhim apo mbi zhdukjen e klasave, i plotësonim nga vetja jonë me përfytyrime që arrinin deri në detaje të vogla të jetës së përditshme, ndonjëherë thoshim gjëra krejt fantastike, si në utopitë e Kampanelës e Tomas Morit... Kjo s'ka asgjë të keqe, megjithatë...

— Po, sigurisht, — tha Dalani.

— Desha të dilja këtu, që, për të kuptuar të ardhmen, duhet t'i drejtohem historisë: pra, e shihja se më duhej të mbështetesha edhe te historia. Me doemos. E ndieja si një nevojë gjithnjë e më urgjente, sa më tepër që flisnim për të ardhmen. ...Si një kundërpeshë e nevojshme, më kupton?

— Që përfytyrimet të mos rrëzohen... — shtoi Hektori, me emfazën e tij të zakonshme.

Anëtari i Qarkorit bëri një pauzë të shkurtër, sa ndezi cigaren.

— E kam pasur zor, — vazhdoi pas pak, — megjithatë këtu gjeja një dokument, aty një tekst, më tutje një dëshmi të shkruar me dorë. Ja, kështu kam bërë. Pastaj, të gjitha të dhënat nuk janë të sakta gjer në fund. — Diçka iu kujtua dhe heshti pak. Rrudhat vertikale ndërmjet vetullave u thelluan.

— Unë e kam pasur pasion historinë, — këtë herë zëri i tij u bë më i thellë, — por ne kishim në grupin komunist të qytetit, vjete të shkuara, një njeri që më kritikonte për këtë gjë... S'kemi pse merremi me të vdekurit, thoshte ai, ne, komunistët, duhet të shikojmë nga e ardhmja...

— Jo?!, — ia bëri Dalani me një habi të dukshme.

— ...vetëm kështu mund të shkëputeshim, sipas tij, shpirtërisht nga realiteti i prapambetur, pastaj të tërhiqnim me vete edhe të tjerët. Kështu arsyetonte. Por nuk kaloi shumë, atë e kapën karabinierët dhe ai denoncoi shumë nga shokët tanë, të cilët gjithashtu i futën në burg.

— Oh, po, kam dëgjuar për diçka të tillë, — ndërhyri infermieri.

Refren

Kolona gjermane ecte drejt Veriut. Njerëz të hipur në kamionë, pajime artilerie që tërhiqeshin si qenie të sëmura nga mjetet e motorizuara, autoblin-da, tanke — mbi të gjitha këto dhe nëpër të gjitha këto që shpërndarë një si hije e veçantë, një farë makjazhi marramendës ëndërre dhe katastrofe. Autokolona kishte një pamje funebre, atë të një kalvari pa mbarim.

Vakuun, hapësirë boshe në rritje, në thellësi të kraharorit, diku midis mushkërive: e tillë që pak a shumë ndjesia që u përftonte atyre të dyve pamja e kolonës që ikte. Do ta mbajmë vetë qytetin, vetëm ne të dy, të tjerët le të ikin. Tani ata qenë bërë një qenie e vetme, me organe të dubluara; vetëm

një gjë kishin të përbashkët: psikikën. Në ato çaste mendonin njësoj, provonin të njëjtat emocione, të njëjtin boshllëk rritës në thellësi të gjoksit. Ata pritën derisa u zhduk kurrizi i tankut të fundit, përtej vijës së horizontit, si përtej një pragu të amëshuar. Pastaj kthyen mbrapsht triçiklin.

Ata i ranë nja dy herë qark qytetit nëpër fushën e heshtur që shtrihej në të gjitha anët e tij, duke parashijuar kënaqësinë e tyre në zgjedhjen e vendit nga do të hynin. Trauma e zhgënjimit u përzihej tani me një ekstazë të verbër hakmarrjeje. Në përzierje kishte diçka nga kujtimet e betejave të mëparshme, ku kishin marrë pjesë këta dy ushtarë të vjetër: aty ishte nostalgjia për pushtimin-rrufe të Norvegjisë, ishin fitoret në Francë dhe Vendet e Ulëta, pa precedencë në historinë botërore të armëve dhe luftërave, ishte edhe... (si ngashërim, si gërvishtje e shpirtit)... përparimi i menjëhershëm fillestar në Frontin e Lindjes, perspektiva gati e pashmangshme e triumfit final mbi hapësirën më të madhe të botës, Leningradi nëntëqind ditë i rrethuar dhe i masakruar nga predhat, arritja në brigjet e Vollgës, shtrirja e stepave para këmbëve të tyre, e tërë planetit para këmbëve të tyre... hier Stanlingrad, hier Stalingrad... Front am Wolga... radiostacioni i parë i Rajhut në brigjet e Vollgës, Krishtlindja 1942... sundonte ende si një makth në trutë e tyre; pastaj, pak nga pak, por pa ndërprerje, trupi i Rajhut që tkurrur si në një ngërç të tmerrshëm. Tani ushtritë e tij po iknin të mundura edhe nga Shqipëria. Do ta mbajmë vetë qytetin, të tjerët le të ikin.

Ishte errur. Ata hynë në një rrugë periferike, nga ana juglindore e qytetit. Drita e pjerrët, në

trajtë konike e fenerit të triçiklit binte kërcënueshëm mbi gjithçka. Mitralozi shtinte si në një delir të pandalshëm. Triçikli i afrohej vazhdimisht qendrës së qytetit, në një lëvizje rrethore, duke kaluar nga rruga në rrugë, nga lagjja në lagje. Xhamat e thyer copë-copë binin me rrapëllimë, pastaj drita e pjerrët, e verdhë rrëshqiste më tutje. Triçikli ikte e ikte nëpër qytet duke shpërndarë krisma gjithandej. Tani e tërë nata do të qe e tyre. Një natë pa fund, dhe brenda saj, në qendër të planeve, yllsive të panumërta, galaktikave — ata të dy, dy mbinjerëzit e fundit... Ekstaza e shpagimit i pushtonte vrullshëm.

Por papritmas, në një rrugë pranë sheshit të qendrës u dëgjuan krisma të tjera, të thata. Timoni i motoçikletës bëri disa dredha, dy ushtarët u lëkundën disa herë para-mbrapa dhe më në fund gjithçka ndaloi...

KAPITULLI I FUNDIT

Asimi ishte më këmbë pranë dritares. Kishte kaluar ora dymbëdhjetë dhe nga qyteti nuk vinin më zhurma. Çatitë e pjerrëta, muret e vjetra, kanatet e xhamta, si sy të verbër të panumërt, dhe portat gjigante si prej kështjelle thuajse luftonin të mos bëheshin një me errësirën, të mos shkriheshin në masën amorfe të saj. Mes tyre spikatnin kambanoret e larta dhe minaretë e xhamive, të ngjashme me idhuj të heshtur.

— Sa është ora?, — pyeti përsëri partizani flokëkuq.

Dalani nxori nga xhepi orën me fushë në ngjyrë si të gipsit. Dita e re kishte filluar prej disa minutash.

Gjysmën e ditës së mëparshme Asimi kishte bërë rojë te Banka. Që në fillim aty qenë vulosur dyert, kasafortat; përzierja viskoze ngjyrë portokalli e dyllit dhe e plastelinës ngjitej copa-copa mbi gjithçka.

Aty nga mesdita kishte mbaruar shërbimin dhe kishte dalë. I tërë qyteti qe derdhur nëpër sheshe dhe rrugë. Partizanët qenë përzier me turmën e njerëzve, kështu që Asimi u end një copë kohë të mirë pa gjetur dot shokët e tij. I dilnin përpara fytyra

të reja, të panjohura. Asimit nuk i kishte ndodhur asnjëherë të gjendej brenda një mase kaq të madhe njerëzish, që lëvizte, bisedonte në dialekte të ndryshme, këndonte shumë këngë në të njëjtën kohë, ekzaltohej. Pa e kuptuar as vetë, kishte nisur të këndonte një këngë të njohur, i gjendur papritmas mes një grupi njerëzish. Fytyra të ndryshme, tepër të ndryshme në tiparë, me copa refleksesh në to nga një ndjenjë e përgjithshme dhe e patjetërsueshme... Ndokush që kalonte bri tij, e përshëndeste. Ej, partizan, e thirri më tej një djalë i ri, rreth 18 vjeç ose ndoshta edhe më pak. Partizan. Djali vinte drejt tij, duke çarë përmes disa njerëzve. Eja sot mbas dite te ne, ja, shtëpia e dytë djathtas, merr dhe shokë të tjerë, po deshe. Sa më shumë, aq më mirë... Masa njerëzore lëvizte vazhdimisht, bisedonte në dialekte të ndryshme, këndonte shumë këngë në të njëjtën kohë...

— Shpeshherë, — tha anëtari i Qarkorit, — pas mbledhjeve këndonim një këngë që fillon kështu: Me zorrët e priftit të fundit, do të var të fundin mbret.

— Po, po, ashtu vërtet, — tha infermieri.

Asimi kapi këtë copë bisede, por pas disa çastesh kujtesa e përmyti rishtas. Në mendjen e tij, po rikrijohej vetvetiu, në fillim përmes një ndjesie ngjyrash të ndryshme apo dritash shumëngjyrëshe, pamja e hyrjes së partizanëve në qytet, mëngjesin e një dite më parë; njësitet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare që ecnin në rreshta, midis banorëve vendës, të rritur apo fëmijë, të cilët dyndeshin mbi trotuare, i përshëndesnin me grusht; disa kishin dalë nëpër dritare e ballkone, duke tundur në ajër flamurë të kuq; (ngado fasadat qenë mbushur me

flamurë të kuq, të mëdhenj). Aty afër qendrës njerëzit mbi trotuare shumoheshin. Përreth kishte mbi-shkrime murale, bunkere të shkatërruar, altoparlantë të thyer. Asimit iu kujtua pastaj kambanorja e kishës së madhe; në katër faqet e saj ishte ora e qytetit, me akrepa të palëvizshëm.

— Çfarë po mendon?, — dëgjoi që prapa zërin e anëtarit të Qarkorit.

— Hiç, ja ashtu, kot... se si më erdhi në mendje Ora e vjetër, kur dëgjova të pyesnin për orën, — u përgjigj Asimi.

— Ajo ka ngelur, për ta është viti zero, — tha Dalani.

Asimi u ul rishtas.

— Këtu në qytet ka pasur edhe një orë tjetër, — tha anëtari i Qarkorit, — në qoftë se e keni parë kullën e ndërtuar sipas tipit venecian, jo larg nga qendra. — Ai vështroi të tjerët përreth, ata që ende nuk po flinin; ata pohan duke tundur kokat. — Dikur ka shërbyer si kullë zjarrfikësi. Kjo ka qenë në shekullin e kaluar. Që andej mund të mbaje syrin mbi tërë qytetin dhe të pikasje vendin ku binte zjarri... Po para shumë vjetësh kaloi këndeje për turizëm një lord anglez, të cilit, si duket, i pëlqeu ora dhe ia bleu komandantit të garnizonit turk, që merrej atë kohë edhe me zjarrfikësit.

Asimi vrau mendjen për një çast dhe arriti ta përfytyronte kullën e gurtë, me fushën në trajtë gjashtëkëndëshi, të zbrazët, me katër brima në vendosje asimetrike.

— Kisha dëgjuar se këtu është fole priftërinjsh, — tha pas pak infermieri.

— Megjithëse sot gati nuk pamë asnjë, — ndërhyri Miti, pa ngritur kokën.

— Po, — tha anëtari i Qarkorit, — është në një farë mënyre kryeqendër klerikale.

Asimi vuri ré se ilegali, kur fliste, gjithmonë i ngushtonte pak sytë.

... — ka një dasi fetare pothuajse në kuptimin klasik të fjalës: nga njëra anë myslimanët, nga tjetra kristianët. Të parët janë më të shumtë në numër, pala tjetër janë më të organizuar dhe më kompaktë.. Konkurrimi shihet kudo, duke nisur që në rastet e festave, në përpjekjet e tyre për të grumbulluar kush e kush më shumë besimtarë. Paraqiten me pompozitet të madh, veshur me rroba ngjyra-ngjyra, disa varin emblema të mëdha, bëjnë podiume e tribuna të ngarkuara me drita, ligjërojnë me orë të tëra përpara njerëzve, ndonjëherë marrin orkestra, organizojnë dhe program këngësh fetare. Në çdo rast përpiqen kush e kush të tërheqë autoritetet e vendit...

— Po popull a ka në të tilla raste?, — pyeti Asimi.

— Zakonisht venë, — tha anëtari i Qarkorit, — madje edhe nga ata që nuk besojnë ose janë të fesë tjetër... më tepër venë thjesht për t'u argëtuar, sesa të shtyrë nga ndjenja e detyrës fetare.

— Gjithsesi ky është mjet që shërben për të tërhequr masën e njerëzve, — tha Dalani.

— Sigurisht, — ia bëri anëtari i Qarkorit, — sigurisht që me anën e këtyre festave e arrijnë qëllimin dhe sado pak ndikojnë, qoftë edhe në mendjet e atyre që shkojnë thjesht për qejf... Nga ana tjetër, ne i kemi shfrytëzuar herë-herë për t'i kthyer në manifestime kundër okupatorëve dhe njëkohësisht ua kemi prishur festën.

Anëtari i Qarkorit bëri një pauzë të shkurtër.

Ndërkohë në dhomë ishte edhe vëllai i Batos, nga kompania tjetër, që ishte strehuar në shtëpitë aty përçark. Ai kishte mbaruar shërbimin e natës dhe, me sa dukej, vinte për të takuar Baton, por ai flinte.

Asimit i kishte rastisur të kalonte një ditë më parë edhe pranë kolegjit të jezuitëve, në një zonë disi të humbur të qytetit. Pranë që një shesh i gjerrë katërkëndësh, mbyllur me ndërtesa nga të gjitha anët. Nuk kishte njerëz dhe thua jse nuk dëgjohej asnjë zhurmë, ngjante sikur gjithçka kishte ngelur e pandryshuar, që nga krijimi i botës. Sheshi mbulohej nga një pluhur i verdhëremë. Dritare me karnate druri, dyer të ulëta. Të vetmuara në mes të sheshit, tri-katër shkallë, të bëra s'dihet pse dhe që nuk të shpinin asgjëkundi, sikur ngeleshin në boshllëk. Gjithçka aty dukej statike dhe memece.

Asimi ngriti kokën përsëri dhe bëri një gjest të vogël, si për të larguar përhumbjen.

— Armët i gjetëm të fshehura në kuzhinën e tij, — tha Dalani, duke përfunduar atë që po tregonte.

Dhjetë ditë më parë, në Tiranë, bashkë me Asimin, Baton dhe disa të tjerë, kishin qenë për kontroll në shtëpinë e një borgjezi. Ju sikur jeni kundër pronësisë, ç'i doni paratë, u kishte thënë ky me një ironi të dukshme. Po armët pse i grumbulloni. Ai kishte dashur të ruante një farë vetësigurie dhe kryelartësie kundrejt partizanëve, duke u përpjekur të merrte pozën e të mundurit krenar, por gjithnjë duke pretenduar asnjësinë politike. Dalani ia kishte prerë shkurt në fillim, po pastaj nuk kishte duruar dhe i kishte hyrë një debati të gjatë, me fjalë të tërthorta, ngacmuese nga të dy anët. Asimi kishte qenë tërë kohës aty dhe nuk kishte

ndërhyrë. Por pikërisht kur shkëmbimi i replikave ishte acaruar në kulm, partizanët e tjerë, që ndërkohë kontrollonin shtëpinë, ishin kthyer me paratë dhe armët e gjetura.

— Kur pa se i gjetëm edhe armët, iu pre goja menjëherë, — tha Dalani.

Ja, i kishte thënë atëherë Asimi, duke mos u përmbajtur më, ja asnjënjësia jote. Asimi kishte dashur të shfrynte akoma, por kishte parë se tjetri që prishur krejt në fytyrë, mezi mbahej në këmbë nga tmerri.

— E vetmja gjë që bëri pas kësaj, — tha Dalani, — ai zgjati vetë duart që t'ia lidhnim.

Dalani ndezi cigaren e fundit, që i kishte mbetur dhe hodhi kaushin në zjarr.

— E gjete korrierin?, — iu drejtua Asimit, duke ulur zërin që të mos shqetësonte ata që flinin.

— Ëhë, e gjeta, — tha Asimi.

— Sot mund të kemi mjaft punë.

Asimit dalgadalë po i rëndoheshin kapakët e syve. Poshtë tyre kalonte një si djegie e lehtë, megjithatë vendosi të rrinte akoma zgjuar. Nuk mund të flinte këtë natë. Ishte nata e parë e glirimit, dhe ai donte ta ndiente të plotë rëndësinë e saj. Për këtë, donte ta kalonte me shokët dhe jo në gjumë.

Përballë tij Dalani vazhdonte të thithte cigaren. Asimi e njihte atë prej disa muajsh, që nga formimi i Brigadës. Ndonëse kjo ishte një periudhë e shkurtër kohe, ata qenë bërë shokë të ngushtë dhe rrinin gjithnjë bashkë. Në fshatin e tij, në jug, Asimi kishte prindërit, një xhaxha, disa kushërinj; vëllezër e motra nuk kishte. Kështu, Dalani i mbushte edhe një boshllëk, ishte deri diku për të si një vëlla i madh. Nga ana tjetër Dalani gjente diçka

thellësisht të afërt në sjelljet e prera dhe të thjeshta, në druajtjen e Asimit, në mprehtësinë e natyrshme të tij; gjatë këtyre pak muajve Asimi qe bërë një nga njerëzit më të afërt për të.

— O Hektor, Hektor, — tha Miti gati pa zë. Ai ishte ngritur nga vendi i tij i mëparshëm dhe tani rrinte pranë Hektorit, i cili qe shtrirë me kokën mbështetur mbi një çantë shpine.

— Lëre, — tha infermieri.

— Jo, nuk po fle, — tha Miti.

Hektori i kishte sytë hapur. Ai u ngrit përgjysmë dhe u mbështet mbi parakrah. Të dy nisën të bisedonin.

— Afrohu pak të të shoh plagët, — ndërhyri infermieri, duke shkuar vetë te Miti.

Anëtari i Qarkorit kaloi njëherë dorën mbi flokët e tij; dukej se mendonte për diçka.

Asimi gjithashtu rrinte i menduar. Iu kujtua prapë Meri dhe ndjeu një shtrëngim brenda gjoksit. Tërë pasditen kishte dashur ta takonte, por nuk e kishte gjetur dot.

— A është larg Berlinit Prusia Lindore?, — u dëgjua Miti, që pyeste prapë Hektorin.

— Ç'dreq njeriu je?! Tani në mes të natës të ra ndër mend Prusia Lindore...

Meri qe një gjimnaziste nga qyteti, në një batalion me Asimin, por në kompani tjetër. Si gjithmonë, edhe dje ai kishte dashur ta takonte, por s'e kishte takuar dot. Ai nuk ia kishte shprehur atë që ndiente, madje i dukej sikur asnjëherë nuk do të kishte kurajë ta bënte këtë. Kur takonte Merin, i ndodhte nganjëherë që i krijohej përshtypja se bëhej qesharak në sytë e saj. Por më pas, kur ishte vetëm dhe kujtonte ndonjë gjë, vinte ré se edhe

nga ana e saj kishte një farë përgjigje. Megjithatë nuk i kishte thënë asnjëherë çfarë ndiente... Njëherë, gjatë një pushimi në marshim, kur ai po pushonte dhe nuk kishte asnjëri aty pranë, ai kishte shkruar mbi pluhur: «Meri, ti je vajza më e bukur në botë», por pastaj e kishte fshirë. Ndoshta askush nuk do ta shihte, po prapë ai e kishte fshirë.

Cigarja e Dalanit ndriçonte si një sy i kuq, i rrumbullakët. Ndërkohë dera kërciti dobët, lëvizi pak, pa e shtyrë askush.

— S'ka njeri, — tha anëtari i Qarkorit.

— Jo, është ai, — u hodh Miti, me fytyrën në formë trekëndëshi, gati si maskë. — A ju thashë që pas dymbëdhjetës do të shndërrohej në gogol?...

Në dhomë ra heshtje, por vetëm për një kohë të shkurtër, sepse pas pak u prish nga toni i dystë, i njëtrajtshëm i vëllait të Batos.

— Duhet të iki, — tha ai duke u ngritur, — në mëngjes marr shërbimin përsëri.

Refren

Atë mbasdite triçikli i erdhi disa herë rrotull qytetit, duke kërkuar pikën nga do të godiste. Ishin të shqetësuar se mos u mbarohej benzina dhe ja, u afruan me shpejtësi te një çisternë e shkatërruar, gjysmë e djegur, mbetur nga autokolona. Midis fushës, figura e saj paksa e prirur mënjanë dukej një sajim i çuditshëm, me një përzjerje të ligjeve të teknikës së re në konstruktin e vet metalik me diçka nga rrënoja qytetesh të dikurshme.

Triçikli vërtitej përsëri. Me sa dukej, goma e parë që më tepër e fryrë seç duhej, sepse në vrapi-

min e tij kishte një përhedhje si prej kali. Vërtitej e vërtitej pa fund; qenie e dyfishtë, e ngjashme me një centaur, ai kapërcente kufijtë e kohërave, duke qëndruar si kanosje diku në periferitë e tyre.

Vazhdim i kapitullit të fundit

Asimi kishte shtrirë këmbët dhe qe mbuluar përgjysmë me kapotën gjermane. Edhe të tjerët qe në shtrirë. Në dhomë ishte qetësi, dëgjohej vetëm brambullitja e vazhdueshme e zjarrit. Në oxhak, një hapje e rregullt e murit, pothuajse në formë kubi, drutë digjeshin ngadalë, tani me një flakë disi më të vogël. Asimi kundroi një çast zbukurimet e shumta që mbulonin tavanin, relievin e tyre si një hartografi e çuditshme. Iu kujtua kur shihte hartën e parë në jetën e tij: ja Vlora, ja Përmeti, ja dhe fshati i tij, shënuar me një rreth që mezi dukej... ja edhe Mokra, këtu kaluam dje, këtu ishte autokolona, një kuçedër e prerë copa-copa dhe e djegur, kuçedra e ujit, kuçedra e zjarrit. Figurat u bënë si me njolla të shndritshme, filluan të lëviznin, të ndërrojnë format, vendet. Përsipër tij ishte një qiell i tërë me njolla të shndritshme lëvizëse. Pak nga pak ai po futej në një gjendje të ndërmjetme, që nuk i përkiste plotësisht as mbretërisë së gjumit, as pagjumit, një gjendje ku përplaseshin e përziheshin copa ligjëratash, gjymtyrë dialogjesh nga dita e djeshme...

Papritur dëgjoi diçka që i tërhoqi vëmendjen; iu duk se dikush, një zë njëkohësisht i njohur dhe i papërcaktuar, e thirri në emër. U çua, fërkoj sytë me dorë dhe shkundi mbetjet e fundit të dremitjes.

Vështroi njëherë përreth. Ata qenë shtrirë mbi dërrasat e dyshemesë. Miti nuk flinte, por qëndronte brinjas me pelerinën hedhur supeve, me shkujdesjen e tij të përhershme. Edhe partizani flokëkuq, pak më tutje, ende ishte zgjuar, me sytë nga dritarja. Të tjerët flinin, anëtari i Qarkorit, Dalani, pranë tij infermieri i kompanisë; Batoja, ashtu në gjumë, kishte një pamje thuajse të butë dhe ngjante pak ndryshe, ndërsa ashpërsia, që u jepte tipareve të tij një hije burrërore, kishte ngelur ndoshta vetëm në pjesën midis mjekrës dhe gojës; pastaj Hektori, me fytyrën paksa të zbetë, kishte mbështetur kokën mbi një çantë shpine. Dëgjohej vazhdimisht brambullitja e zjarrit. Disa prej tyre i kishte njohur ditët e para kur kishte dalë partizan, disa para pak muajsh, ndonjërin javën e fundit. Periudha kishte qenë e shkurtër, betejë pas beteje, krisma armësh, shpërthime bombash, zjarre ndërmjet dy betejave, marshime të shpeshta — të gjitha këto përbënin tani lidhjen e qëndrueshme midis këtyre njerëzve, që deri para pak kohësh nuk njiheshin dhe nuk dinin asgjë për ekzistencën e njëri-tjetrit. Të gjithë kemi, si të thuash, enë komunikuese që na bashkojnë sistemet e qarkullimit të gjakut. Asimit iu kujtua përsëri ajo që i kishte thënë mjeku i një spitali partizan. Enët komunikuese e bashkonin me shokët që kishte brenda në dhomë dhe me ata që ishin jashtë saj, në dhomat dhe korridoret e tjera, me partizanët që ishin shpërndarë në gjithë atë qytet, apo në sallat e gjimnazit të vjetër, në ish-prefekturën, në ish-kazemat e xhenjos. Muret e ndërtesës filluan të shembeshin, të shpërbëheshin: gurët, gëlqerja, xhamat, trarët, gjithçka thërrmohej në çast dhe në përfytyrimin e tij shfaqeshin partizanë nëpër pllaja të

ftohta, fshatra, qytete të porsaçliruara, në gjithë Shqipërinë.

Si do të jetë më vonë, përsëriti ai me vete, pa e kuptuar se si i erdhi në mend, pyetjen të cilën ia kishte bërë një shoku të tij gati një vit më parë, gjatë Operacionit të Dimrit, në malësitë e Çermenikës. Asimit nuk i dukej e rastit që pikërisht tani, në fillimin e ditës së parë të çlirimit, pandërprerë i riktheheshin në kujtesë, me një qartësi pak të habitshme, mjaft nga ngjarjet e mëparshme të luftës.

Atëherë e patën caktuar në praparojë, bashkë me disa partizanë të tjerë të batalionit. Me vete kishte tre të plagosur. Ata ecnin përmes dëborës që binte pareshtur, u shmangeshin fshatrave të djegura, të pushtuara nga gjermanët dhe nga bandat. Ky marshim u dukej sikur nuk kishte të sosur, po më në fund gjetën një kasolle, diku në pyll, një stan të braktisur. Bënë një zjarr të madh dhe kaluan aty tërë natën, ndërsa nga jashtë vinin ulërimat e ujqve, që bashkoheshin me erën në një kor të madh ogurzi.

— Si do të jetë më vonë, pastaj?, — kishte pyetur Asimi.

— Kur pastaj?

— Mbas të fitojmë, — kishte thënë Asimi dhe kishte vështruar i habitur, ngaqë tjetri nuk po e kuptonte, — në komunizëm... — Reflektet e flakëve krijojnë një lojë hije-drite në fytyrën e tij, duke i dhënë një pamje të veçantë, disi më serioze.

Shoku i tij e kishte vështruar me miratim. Në fillim i kishte folur për Republikën e Platonit, për Furienë, për Marksën, për Leninin, pastaj i kishte shpjeguar gjerë e gjatë, po thjesht, se në të ardhmen prona do të qe e përbashkët, kolektive, të gjithë do të ishin të barabartë, do të merrnin sipas pu-

nës. Ndërkohë njëri nga të plagosurit po përpiqej të thoshte diçka. Përpjekja e tij ishte e mundimshme përtej masës, ngaqë trupin e kishte të mbushur me plagë dhe njëren nofull gati të thyer. Komunizmi... buzëqeshjet e pastra të fëmijëve... më shumë diell... Më së fundi i plagosuri kishte arritur të shqiptonte gjysma-gjysma, si në kllapi, disa nga vargjet e poezive që kishte shkruar dikur, fshehurazi profesorëve të gjimnazit... Komunizmi... një shpresë e re e njerëzimit... Jashtë ishte natë dhe dëgjohej kori i ujëve...

Të tjerët vazhdonin të rrinin shtrirë. Flaka në oxhak bëhej përherë më e vogël. Si kompensim i saj, nga ana e horizontit, ku fillonte një vargmal, vinte një dritë e mugët, që rritej e rritej ngadalë me këmbëngulje, duke i dhënë kupolës së qiellit një ngjyrë tunxhi. Muret dhe çatitë e shtëpive, mijëra kube, piramida, prizma me konture aty-këtu të shpërbëra, të fshira nga nata, tani po rimerrnin pak nga pak trajtat e tyre të mëparshme.

Prapë Meri. Asimi tani e përfytyronte qartë pamjen e saj, me një xhakëtë të gjelbër, me shall, me bustinën e vënë me kujdes pak anash, fytyrën ovale, hundën pak të ngritur. Ai kishte një kujtesë pamore pak a shumë të fortë dhe, sa herë që sillte ndër mend fytyrën e saj, ndiente atë ngushtimin e zakonshëm në gjoks, një si përmbytje që ndodhte brenda qenies së tij.

Asimi deshi të kujtonte zërin, por ai i shkiste gjithmonë, nuk arrinte ta fiksonte dot.

— Ç'po mendon? — Asimi dëgjoi zërin e anëtarit të Qarkorit.

— Asgjë, ja, po rrija kot, — tha ai dhe u skuq,

pastaj, për një çast, si një vegim iu shfaq dhe u zhduk përsëri trupi i statujës së shatërvanit.

U dëgjuan lëvizje dhe të folura nga ndonjë korridor diku pranë. Zhurmat vinin duke u shtuar, po mbas pak reshtën. Në dhomën e tyre tashmë të tërë partizanët ishin zgjuar. Infermieri mori këpuçet e tij me qafa dhe po i vishte. Hektori qëndronte në këmbë pranë dritares, duke mbështetur lehtë shpinën në xham. Dalani kaloi njëherë gishtat nëpër flokët e tij të drejtë, pastaj u çua ngadalë. Të tërë lëviznin, ecnin lart e poshtë dhomës, merrnin armët e varura në dorezat e dritareve. Asimi u shpi, veshi kapotën gjermane dhe zuri t'i shkundte pluhurin që kishte marrë në dysHEME.

— A fjetët mirë?, — tha ai.

— Ti je akoma pa gjumë, — tha anëtari i Qarkorit.

Nga dhomat e tjera tani vinte një zhurmë më e shtruar. Asimi hapi derën dhe doli me Mitin e Baton. Në katin e sipërm vazhdonte lëvizja. Përbri tyre kaloi me nxitim komandanti i kompanisë, duke i nderuar me grusht. Duke zbritur, dora e Asimit rrëshqiste lehtë mbi parmakun e shkallëve. I mëshoi pak dorës. Nga fërkimi i saj me mermerin dëgjohej një vërshëllimë e mbytur. Në sallonin e katit të parë lëvizja ishte më e madhe: partizanë që coheshin, merrnin pajimet, disa dhe armët, ecnin sa andej-kënde, formonin grupe prej tre-katër vetësh dhe fjaloseshin midis tyre, shpërndaheshin, formonin prapë grupe më tej. Zhurma gjithfarësh, duke filluar nga copat e fjalëve, frazave, rrokjet që dëgjoheshin të shkëputura e deri te zhurmat e shkaktuara nga këmbët, hapat, vendosja e diçkaje përtokë. Dikush kërkoi një laps për të shkruar një

letër për shtëpinë. Dy vetë diskutonin për largësinë e kufirit verior dhe jugor të Shqipërisë. Dikush tjetër, një djalë me flokë të ashpër ngjyrë gështenje, të cilin Asimi e njihte, po fliste për shfaqjen artistike që do të jepte teatri partizan në bashkëpunim me grupin e estradës. Dikush më tutje kërkonte vazhdimisht një biçak që, me sa dukej, i kishte humbur. Pranë derës, intendentin pyeste një skuadërkomandant për numrin e batanijeve që kishte skuadra e tij. Ngjyra të hirta, të gjelbra, të kuqe. Një partizane himarjote me sy të mëdhenj hapi dritaret e sallës.

— Unë po rri me Iljaz Kepin, — u tha Batoja dy shokëve të tij.

Asimi dhe Miti dolën në oborr duke kaluar nëpër sheshin dhe rruginën me pllaka të gurta. Pranë shatërvanit Asimi ktheu kokën si rastësisht në anën tjetër. Ata të dy ecën përmes shtretërve të luleve, pemëve frutore të zhveshura, vetëm tek-tuk me ndonjë gjethë, dhe arritën te porta e madhe prej druri.

Ndonëse akoma herët, përjashta kishte një farë gjallërie. Fasadat, rrugët, muranat e oborreve, pragjet, gjithçka dukej si në pritje, sikur priste të fillonte nga e para ekzistencën e vet dhe të vendoste kontaktet me një realitet të paprovuar më parë.

Në qytet kishte lëvizje. Afër tyre kaloi një grua me një kovë të rëndë druri, mbushur me ujë. Ata ecën më tej. Në anë të rrugës që një shtyllë e thyer; te ganxhat e izolatorëve qenë mbështjellë dhjetëra copa telash të zinj.

Nata tashmë ishte shpërndarë, duke u grumbulluar në të njëjtën kohë, e koncentruar, në funde skutash të ftohta, gropa të thella me ujë të ndenjor. plasaritje drurësh e trarësh. Kishin filluar lëvizjet

e para. Ata përshkuan sheshin e lagur, ku reflekto-heshin të përcudnuara objektet dhe ndërtesat për-reth. Asimi dalloi në mbulesën e ujshme shembëll-tyrën e shtrirë të kabanores dhe mbi të Orën e Madhe me shigjeta të paralizuar, me shifrat si një grumbull merimangash, pa jetë; fusha e saj nuk ishte më rrethore, tani ajo që zgjatur dhe përafrohej me një fytyrë të shtrembëruar, në një përzierje grimase dhe agonie. Më tutje, përtokë, ishte gazeta e grisur: «Qëndresë e pashembullt e Wermacht-it në brigjet e. . .», si një relik kohërash tanimë tepër të largëta. Ndërkohë nga anë të ndryshme të sheshit filluan të vinin kalimtarë dhe vetëm atëherë ata vunë re se para disa çastesh kishin qenë vetëm. Asimin e kishte kapur një ndjesi e çuditshme. Sendet përreth befaf largoheshin prej tij me një shpejtësi marra-mendëse, ndërsa ai vetë pothuaj lëvizte në një përmasë tjetër të hapësirës: shikimi i tij treqej diku tutje në horizont, nga ana e një vargmali. Prej andej vinte, duke u rritur çdo sekondë, një e bardhë verbuese, një si plazmë që merrte formë pak nga pak. Ajo përthyej në një numër pafund grimcash të imta, përftonte një si dridhje ajrore. Qielli merrte të gjitha nuancat ndërmjet së bardhës dhe së kal-trës. Asimit në ato momente sikur i bëhej e prekshme, gati lëndore, ideja e ardhjes së një dite të ré. Komunizmi... buzëqeshjet e pastra të fëmijëve... me shumë diell... Atij iu kujtuan përsëri copa var-gjesh që kishte dëgjuar dikur nga goja e një parti-zani të plagosur.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
1) Kompozim me basoreliev dhe grup skulpturor	3
2) Rënia e perëndive	20
3) Duke u kthyer	34
4) Në korijen e lisave	39
5) Instrumenti	52
6) Zhurma e daulles	65
7) Një kohë tjetër (novelë)	71